

KUR VLERAT NDESHEN



Dukurive negative që njollosin imazhin e myslimanëve duhemi tu kundërvihemi me qasje pro-aktive që nuk e pranon konceptin e obligimit kolektiv, shpeshherë gabimisht i kuptuar si: **dikush tjetër duhet të reagoj**. Nëse nisemi nga hadithi i cili bashkësinë myslimane e ngjason me një trup dhe në të cilin ndodhitë në një pjesë të trupit nuk ngelin pa reagimin e pjesëve tjera, atëherë nevoja për angazhim përmirësues të menjëhershëm shfaqet në formë akoma më të theksuar.

Thënë ndryshe ka kohë që të gjithë jemi detyruar të marrim hisen e përgjegjësisë dhe hisen e angazhimit.

Nevojat individuale me llojet e saja janë fakt i pamohueshëm në jetën e njeriut bashkëkohor. Plotësimi i tyre brenda kornizave të sheriatit është i lejuar, i preferuar dhe në disa raste edhe i detyruar. Njeriu ka nevojë për ushqim, për veshmbathje, për jetë intime, për kënaqjen e ëndjeve dhe pasioneve... ka nevoja që duhen plotësuar brenda asaj që sipas Islamit vlerësohet si e lejuar. Mohimi i këtyre nevojave është dalje nga konceptimi i fesë islame për njeriun si krijesë. Në këtë kohë, e cila tanimë ka arritur fazën e dinamikës skajshmërisht dezintegruese dhe të shpejtë, plotësimi i nevojave individuale në shumicën e rasteve kryhet pa përkufizimin fetar. Një dukuri shqetësuese është zbatimi ditor i standardeve të dyfishta. Ngjashëm me ndryshimet e motit ndryshojnë qëndrimet edhe vlerësimet për situata të ndryshme. Kriteret dhe njësitë e matjes rrënjësisht dallojnë kur në pyetje është vet individi si veprues dhe kur në pyetje është dikush tjetër. Parimet e lehtësisht, faljes, fshehjes, minimizimit, aktivizohen kur fillon vlerësimi i së bërës nga vetë individi. Kur bëhet fjalë për tjetrin, kriteret disi vështirësohen, precizohen në detajet më të imta dhe të duket sikur tani parimet e vlerësimit janë krejtësisht tjera. Harrohen fjalët e buta, stërhollimi dhe në disa raste edhe arroganca e urrejtësit shfaqet në skenë. Sikur nuk jemi Ummeti të cilit Allahu, subhanehu ue teala, i është drejtuar me urdhrin e prerë: **“O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të Allahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve...”** (En Nisa, 135).

Vlerat Islame në bazë të cilave ne e vlerësojmë vetën dhe të tjerët shpeshherë ndeshen me inkoherencën tonë. Me një jo përpikëri gjatë vlerësimit dhe gjatë analizës ne vetëm do e vërtetojmë akuzën e kamotshme për standardet e dyfishta me të cilët gjykojnë myslimanët. Duke apeluar tek besimtarët dhe në të njëjtën kohë duke i përkujtuar ata themi:

“Përcaktimet tona për vlerat që i respektojmë dhe i zbatojmë në jetë janë të qarta dhe të prera. Ato hollësisht i spikat Sheriati, legjislacioni me të cilin Allahu e ka nderuar njerëzimin. Mbetet vetëm që, në si krijesa të dobëta, të njëjtat me angazhim të mundimshëm ditor, t’i shfaqim dhe t’i mishërojmë në **aktualen tonë**, plotë mangësi, duke e afuar atë dita ditës më afër **ideales** ashtu siç paraqitet në Kur’an dhe Sunnet. Kështu nuk do t’i bëjmë zullum as vetës, as tjerëve e as që do të bëhemi argument i përdorur nga qëllimkëqijtë.

p.s. Ndryshimet si moti i kanë hije vetëm motit.

në emër të redaksisë: Talha KURTISHI

AKTUALE

Faktori kombëtar dhe shqiptarët në fund të dekadës së parë të mijëvjeçarit të ri **3-4**

Kosova i qorton arabët **5-7**

Raportet iraniane-izraelite...

Një orvatje për të kuptuar realitetin **8-10**

AKIDE

Dallimet e besimit në mes sunive dhe shiitëve **11-15**

KËNDI IM

Krizë e mjeteve apo krizë e synimit **16-18**

Milingona **19-23**

Investimet për botën e ardhshme **24-26**

FIKH

Shpëtimi nga pasuria haram, siç është kamata (vazhdon nga numri i kaluar) **27-30**

AVANCIMI PERSONAL

Angazhimi **31-32**

FAMILJA

Mirësjellja e besimtarëve me gratë e tyre **33-36**

Inkurajimi për sjellje të mirë **36-38**

Llukmani alejhi selam - shembull për udhëzimin e fëmijëve **39-40**

TEFSIR

Hutimi pas dynjasë **41-44**

HADITH

Duaje të mirën edhe për të tjerët **45-48**

LIBRI

Sulltani i Fundit **48-51**

BOTA ISLAME

Afganistani & Algjeria **52-54**

FETVA DHE KONSULTIME

Disa pyetje **55-57**

HISTORI

hidri dhe gjurmët e tij mes realitetit dhe besëtytnive **58-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor

Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI, Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI, Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.

Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA

Roald HYSA – redaktor gjuhësor

Halil BERISHA – redaktor teknik

Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina

Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: albislam@gmail.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 1400

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

NUN-R DOOEL

Xhirollogaria: 300000001759616

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denar)

Xhirollogaria: 0270100209184

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro)

rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4

S.W.I.F.T. : KOB5MK2X

IBAN MK07300701002091869

Numri tatimor: 4030003487017

FAKTORI KOMBËTAR DHE SHQIPTARËT NË FUND TË DEKADËS SË PARË TË MIJËVJEÇARIT TË RI

Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës mori fund një herë e mirë shpërbërja e ish-Jugosllavisë, duke u shndërruar kështu radikalisht harta e Ballkanit dhe duke dalë në dritë një realitet i ri politik

SHKRUAN: ROALD A. HYSA

Ndarjet politike ndërkombëtare ndikuan ndjeshëm tek shqiptarët në këtë gjysëm shekulli që kaloi. Ato e fraksionuan më tepër identitetin e tyre kombëtar dhe i vendosën ata përpara zgjedhjeve të detyruara politike. Ishin pikërisht këto zgjedhje të detyruara nga ideologjitë politike dhe kufijtë politikë ato që sollën dëmtimin e mëtejshëm të identitetit kombëtar. Në mesin e shekullit të kaluar shqiptarët u ndanë në tre entitete të ndryshme politike, ku secili prej tyre paraqiste nga një problem më vete. Shteti i ri shqiptar që po ngrihej brenda kufijve londinezë i bazuar në ideologjinë bolshevike kishte problemet e veta të brendshme për legjitimimin e pushtetit të ri që po ndërtohej. Atyre iu desh të ballafaqoheshin shumë shpejt me masakrat në jug të trojeve etnike shqiptare dhe me shpërnguljet masive të popullsisë myslimane çame, e cila tashmë u përzu përfundimisht nga shovinistët grekë nga trojet e veta, ku kishte jetuar qysh nga lashtësia. Protestat e qeverisë së re komuniste ishin krejtësisht formale dhe ajo u kufizua duke i dhënë ndihmën e parë emigrantëve. Ndërkaq pjesa tjetër e trojeve shqiptare përfundoi në një entitet të ri që e emërtonte veten si Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, e cila në vetvete

HARTA E SHQIPËRISË

GJENDJA E SOTME E KUFIJVE ADMINISTRATIV
DHE GJENDJA REALE E TROJEVE HISTORIKISHT ETNIKE SHQIPTARE



ndahej në republika më të vogla të bazuara në nacionalitetin, rregull ky që nuk vlejti për shqiptarët. Ata u ndanë në republikat e Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë dhe ishte pikërisht kjo ndarje që do të sillte aktet dramatike të gjysmë shekulli më vonë, që e detyruan Bashkësinë Ndërkombëtare me në krye SHBA-në dhe NATO-n të ndërhynin ushtarakisht nga ajri dhe më pas nga toka. Gjatë këtyre ngjarjeve gati një e treta e

popullsisë së Kosovës martire u shpërngul me dhunë dhe me mijëra të pafajshëm u vranë dhe me mijëra të tjerëve edhe sot nuk iu dihet fundi. Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës mori fund një herë e mirë shpërbërja e ish-Jugosllavisë, duke u shndërruar kështu radikalisht harta e Ballkanit dhe duke dalë në dritë një realitet i ri politik. Deri dje me ndryshimet politiko-ideologjike pushteti i kufijve politikë kishte qenë tejet i ngurtë, qoftë në marrëdhëniet e brendshme, qoftë edhe në marrëdhëniet e jashtme dhe veçanërisht në marrëdhëniet e jashtme duke mos lënë shteg për zgjidhje. Me gjithë ndryshimet e rëndësishme politike që ndodhën, politika e brendshme dhe e jashtme e shtetit grek pavarësisht nga ideologjitë që udhëhiqeshin partitë që hipnin në pushtet njëra pas tjetrës, ishte dhe mbetet e njëjtë. Të majtë apo të djathtë shfaqeshin dhe shfaqen njësoj kur vjen fjala për minoritetin shqiptar çam, që u shpërngul me forcë në vitin 1945. Ata vazhdojnë të mos pranojnë të paguajnë dëmshpërblimet dhe tokat e kërkuara nga çamët dhe në këtë linjë ata shfaqen jashtëzakonisht agresivë në politikën e tyre të jashtme. Ndërkaq brenda vendit për të larguar sadopak vëmendjen nga problemet e jashtme shqiptare, regjimi komunist i dha një shtysë përkeqësuese mentalitetit lokalit e rajonal, duke i vënë në pozita të këqija çamët e shpërngulur dhe kosovarët dhe i njëjti mentalitet u shfaq edhe me ardhjen e kosovarëve të parë në Shqipëri, në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar.

Pak a shumë e njëjta gjë po ndodh këto ditë edhe me serbët, pasi një pjesë e mirë e faktorit ndërkombëtar e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Ata nuk e kanë lëshuar Kosovën dhe po përpiqen vazhdimisht të majtë e të djathtë njësoj. Tepër e nderë është gjendja e shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Megjithatë duhet të

“...Të majtë apo të djathtë shfaqeshin dhe shfaqen njësoj kur vjen fjala për minoritetin shqiptar çam, që u shpërngul me forcë në vitin 1945...”

themi se popullsia shqiptare e vendosur në republikat e Malit të Zi dhe të Maqedonisë tashmë gëzon të drejta më të mëdha dhe me gjithë kufijtë politikë ekzistues, tashmë ideologjitë e vjetra ranë në këto dy ish-republika jugosllave dhe shqiptarët kanë më tepër mjete politike për të luftuar dhe për të fituar të drejtat e tyre. Gjithashtu kufijtë e tyre shtetërorë nuk janë më aq të ngurtë sa në të kaluarën dhe ato mund të përshkohen shumë lehtë tashmë, një favor i madh ky për thyerjen e mendësive dhe afrimin shpirtëror të shqiptarëve.

Ky fleksibilitet politik i krijuar nga rrethanat e reja diplomatike duhet shfrytëzuar tashmë për afrimin e mëtejshëm të shqiptarëve për të zhdukur sadopak diferencat e ndryshme të shkaktuara nga pushtetet politike të bazuara në ideologjitë politike shoviniste antishqiptare. Epoka e globalizimit dhe e internetit është një nga mënyrat më të shpejta të ndërveprimit mbarëshqiptar dhe që i zhduk apo i bën të pandjeshëm kufijtë politikë dhe fizikë. Ne duhet ta shfrytëzojmë këtë çast domethënës politik ndërkombëtar për të zënë një vend të rëndësishëm në Ballkan dhe njëkohësisht për të shkuar drejt bashkimit të pashmangshëm të të gjithë elementit shqiptar. Por na duhet gjithashtu të luftojmë dhe të dalim mbi mentalitetet lokaliste dhe rajonale për të larguar përfundimisht kompleksin e inferioritetit, që na ka kapluar deri në këto çaste. ■

KOSOVA I QORTON ARABËT

Këtë gjë e kanë debatuar edhe disa gazeta në Kosovë dhe janë munduar të gjejnë fajtorin për këtë gjë, normalisht duke kërkuar që fajtorin ta gjejnë te feja, mirëpo nuk kanë arritur të japin ndonjë përgjigje konkrete

SHKRUAN: BEKIR HALIMI

Pavarësia e Kosovës pa dyshim se për të gjithë shqiptarët, ku në shumicën dërmuese janë muslimanët, paraqet ndodhinë më të madhe të historisë sonë moderne. Këtij akti i janë gëzuar të gjithë shqiptarët, po edhe muslimanët e botës mbarë, mirëpo ne si hoxhallarë shpesh jemi ballafaquar me pyetje të shumta të xhematit: pse bota islame akoma nuk e ka pranuar pavarësinë e Kosovës?

Secili është munduar t'u japë përgjigje të ndryshme, mirëpo para se të dalim te përgjigja e kësaj pyetje të shohim se çfarë ka

ndodhur në Kosovë dhe në botën islame e atë arabe gjatë këtij procesi.

Fillimisht vitin e kaluar para se të shpallet pavarësia e Kosovës, në kohën kur të gjithë shikonin të llobojnë për lehtësimin e procesit të pavarësisë, kishte mosmarrëveshje mes Veton Surroit dhe Fatmir Sejdiut, rreth pjesëmarrjes së përfaqësuesit të Kosovës në Konferencën Islamike, që u mbajt asokohe në Pakistan. Pa dyshim që ky ishte një hap aspak pragmatik e aq më pak i drejtë.

Pastaj në çastin kur u shpall pavarësia e Kosovës pati një deklaratë të përgjithshme nga Konferenca Islamike për pranimin pavarësisë së Kosovës, mirëpo kjo nuk u pasua me konkretizimin e saj nga shtetet anëtare në këtë konferencë... Për këtë shkak

pati reagime konkrete nga shumë dijetarë muslimanë, që kanë emisione të ndryshme në kanale satelitore, për vonesën e shteteve arabe në pranimin e shtetit të Kosovës. Prej tyre ishte edhe shejh Selman Aude, i cili është një dijetar shumë i njohur në botën islame, mu ky në emisionin e tij “Jeta është fjalë” në kanalën shumë të njohur MBC foli për këtë gjë dhe kërkoi nga qeveritë arabe njohjen sa më të shpejtë të Kosovës.

Ai mes të tjerash tha:

“Kërkoj nga Organizata e Konferencës Islamike dhe Liga Arabe që të nxisin shtetet anëtare në këto organizata ta pranojnë këtë shtet, të krijojnë raporte politike, ekonomike, kulturore dhe shkencore. Muslimanët duhet ta përkrahin këtë shtet të ri”.

Shejh Selman Aude në këtë emision parasheh një të ardhme të mirë për Kosovën, dhe se arabët e muslimanët duhet ta përkrahin politikisht dhe ekonomikisht, si dhe me shkëmbimin e dijes dhe të kulturës.

Këtë gjë e kanë debatuar edhe disa gazeta në Kosovë dhe janë munduar të gjejnë fajtorin për këtë gjë, normalisht duke kërkuar që fajtorin ta gjejnë te feja, mirëpo nuk kanë arritur të japin ndonjë përgjigje konkrete, përpos faktit se disa shtete arabe kanë lidhje të ngushta me Rusinë dhe se disa shtete, sidomos pas 11 shtatorit ushqejnë armiqësi ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kurse pavarësia e Kosovës është një arritje e tyre, prandaj edhe ata hezitojnë ta pranojnë këtë pavarësi.

Një version tjetër është se disa shtete islame dhe jo-arabe kanë problem me provinca të tyre, të cilat mund ta përdorin pavarësinë e Kosovës si precedent për t'u shkëputur edhe ata nga shteti i tyre amë.

Në kohën kur nga ana serbe marrin pjesë delegacione të niveleve më të larta, madje edhe kryetari i tyre në konferenca të ndryshme në Lindjen e Mesme dhe Afrikë,

niveli i delegacionit kosovar në Konferencën Islamike shkon deri në rrafshin e ministrit të arsimit. Pa dyshim se edhe kjo tregon mungesën e pragmatizmit në diplomacinë kosovare, apo një lloj kompleksi inferioriteti nga kontaktet dhe lidhjet me botën islame.

Përderisa delegacionet kosovare të nivelit më të lartë gjejnë kohë të marrin pjesë në seminare të organizuara nga fondacione private dhe joqeveritare evropiane, ata nuk gjejnë kohë të marrin pjesë në konferenca të nivelit rajonal, sikurse është Konferenca Islamike, apo Konferenca Afrikane.

Sa për njoftim në Konferencën Afrikane mori pjesë vetë kryetari i Serbisë për të luftuar pranimin e pavarësisë së Kosovës, kurse në atë konferencë nuk kishte asnjë përfaqësues nga qeveria kosovare.

Pranimi i pavarësisë së Kosovës do të kishte ndikim në forcimin e raporteve mes muslimanëve shqiptarë dhe muslimanëve të tjerë, e kjo ndoshta dikujt edhe i pengon, prandaj edhe nuk lobon aq shumë sa për të jetësuar raporte të këtilla, qoftë nga qarqet kosovare, apo nga ato ndërkombëtare.

Sipas disa qarqeve pranimi i pavarësisë së Kosovës nga bota islame do të kuptohej edhe si një argument shtesë për serbët, të cilët kanë trumbetuar vazhdimisht për një prani të fundamentalizmit islamik në Kosovë, gjë për të cilën ata janë munduar të hulumtojnë e të gjejnë, madje edhe të sajojnë fakte të tilla, prandaj sipas tyre edhe nuk duhet nxituar shumë në këtë drejtim nga pala kosovare.¹

Këtë dis-harmoni të qëndrimeve të shteteve islame dhe popujve të tyre, përveç qëndrimeve të dijetarëve islamë e ilustrojnë shumë mirë edhe shumë shkrime të analistëve dhe shkrimtarëve të ndryshëm, që i bëjnë thirrje qeverive të tyre të nxisin ta njohin Kosovën si shtet i pavarur. Ata gjatë shkrimeve të tyre promovojnë qëndrimet e drejta rreth lirisë dhe të drejtës së popujve

“...në Konferencën Afrikane mori pjesë vetë kryetari i Serbisë për të luftuar pran- imin e pavarësisë së Kosovës, kurse në atë konferencë nuk kishte asnjë përfaqësues nga qeveria kosovare...”

për vetëvendosje, pragmatizëm diplomatik dhe ndërlidhjen civilizuese, gjëra të cilat sjellin një sërë të mirash civilizuese, politike dhe ekonomike.

Një shkrimtar dhe analist arab duke folur rreth këtij problemi mes të tjerash shkruan:

“Besoj se Kosova paraqet një përvojë civilizuese, politike dhe zhvilluese, nga e cila duhet të përfitojnë arabët dhe muslimanët, ose së paku ta njohin atë. Sipas të gjitha gjasave arabët dhe muslimanët do të përfitojnë nga hapja politike dhe ekonomike me Kosovën”.

Ata mes tjerash thonë:

“Qëndrimi i shteteve arabe dhe islame ndaj Kosovës pa dyshim është shumë i pakuptueshëm. Çështja e Kosovës nuk dallon aspak nga çështja e Bosnjës, e cila gëzoi një përkrahje, solidarizim zyrtar dhe popullor shumë më të madh, prandaj përse të sillen ndaj Kosovës me këtë injorim dhe të vonohen në pranimin e pavarësisë së saj?!... ”

Ata pasi flasin për disa shkaqe dhe arsyeime të të dyja palëve për vonesën e pranimin të pavarësisë, shtojnë e thonë:

“Kushdo të jenë shkaqet apo sqarimet për këtë vonesë, qëndrimi arab dhe i popujve musliman ndaj Kosovës nuk mund të arsyetohet dhe të mbrohet, pasi detyrë e arabëve dhe muslimanëve është ta përkrahin Kosovën, duke pranuar pavarësinë e saj fillimisht, pastaj duke hapur ambasada dhe përfaqësi diplomatike në ato vende dhe me pjesëmarrje ekonomike e mediale, e cila do t’u sjellë dobi të gjitha palëve”.

Këta gazetarë dhe analistë duke e njohur dëshirën e popujve arabë për turizëm dhe argëtim, sidomos ditëve të nxehta të verës mundohen që ta promovojnë Kosovën edhe si vend turistik. Ata e paraqesin Kosovën si vend të bukur dhe të përshtatshëm për turizëm veror dhe dimëror. Çmimet janë të pranueshme ose më të lira se në vendet e tjera turistike. Ka qetësi, siguri, pastërti, kurse shërbimet themelore që i interesojnë një turisti vizitor i ofrohen në një nivel të lartë cilësor dhe me çmime të logjikshme. Gjuha angleze flitet nga një pjesë e madhe e popullit, por ka edhe një numër të madh që kanë studiuar apo punuar në botën arabe.

Këto shkrime gazetareske nga gazetarë dhe analistë arabë e paraqesin popullin e Kosovës, si një popull të dashur, fisnik dhe që i duan shumë mysafirët, mund të bashkëpunosh me ta dhe t’u besosh atyre.

Pra, këto ishin disa zëra që burojnë nga brendia e popullit arab dhe musliman, i cili këmbëngul në solidarizimin maksimal me popullin e Kosovës për dallim nga qëndrimi zyrtar, i cili pa dyshim që është shumë i vonuar dhe aspak i logjikshëm apo pragmatik. ■

¹ Fatkeqësisht këtë dilemë e vërtetojnë deklaratat e fundit e kryeministrit të Kosovës pas vizitës që i bëri kryetarit të SHBA - ve, ku tha se i ka premtuar kryetarit Xhorxh Bush se do ta luftojë fundamentalizmin islamik në Kosovë. Parashtrihet një pyetje e thjeshtë logjike: ku ka vend për fundamentalizëm islamik në një vend ku akoma shumica dërmuese e popullit të atij vendi nuk kanë njohuri esenciale mbi fenë Islame dhe mjaftohem vetëm me përkatësinë deklarative kurse nuk kanë asnjë element fetarë në jetën e tyre të përditshme?!

RAPORTET IRANIANE-IZRAELITE...



NJË ORVATJE PËR TË KUPTUAR REALITETIN

Cili është sekreti i kësaj kontradikte: kërcënim dhe përgatitje për sulm në njërën anë dhe në të njëjtën kohë negociata dhe shkëmbim robërish nga ana tjetër?

Raportet iraniano-izraelite shkaktajnë shumë përshtypje dhe paradokse

HASEN RESHID

Në ditët që kaluan, saktësisht më 21 qershor 2008, mediet përhapën lajmet, se zyrtarë në Ministrinë e Mbrojtjes Amerikane vërtetuan saktësinë e raportit gazetaresk, i cili zbuloi se Izraeli ka bërë manovra ushtarake ajrore të mëdha në Lindjen e Mesme, gjë që paraqet një demonstrim të madh të forcës dhe stërvitjes për sulmet ajrore mbi stacionet bërthamore të Iranit.

Si përgjigje të kësaj manovre komandanti i gardës revolucionare iraniane, gjeneral Muhamed Ali Xhaferi i tërhoqi vërejtjen Izraelit, që të mos e sulmojë Iranin, sepse shteti hebraik gjendet në shënjestrën e raketave iraniane dhe aludoi për hapjen e frontit në jugun e Libanit.

Disa ditë më vonë, saktësisht më 30 qershor, mediet përhapën lajmin, se qeveria izraelite me shumicë absolute votash pranoi shkëmbimin e robërve dhe kufomat me Hizbullahin, shkëmbim i cili nënkuptonte shkëmbimin e dy ushtarëve izraelitë, të cilët i

kishte zënë robër partia shiite libaneze në korrik të vitit 2006, për të cilët besohet se janë vrarë, kundrejt liritimit të dy burgosurve libanezë.

Marrëveshja ishte për kthimin e kufomave të dy ushtarëve izraelitë, që u rrëmbyen afër kufirit libanez. Kjo marrëveshje u votua nga 22 ministra prej 25, që ka qeveria izraelite.

Është e ditur dhe nuk ka nevojë të qartësohet, se Hizballahi është krahu i zgjatur i Iranit në rajon. Qoftë Irani apo Hizballahi, nuk e mohojnë këtë të vërtetë, domethënë lidhjen ndërmjet tyre. Këtë gjë e theksoi së fundmi edhe deklarata e Hasan Nasrallahit, sekretari i përgjithshëm i Hizballahit, në fjalimin e fundit ku tregoi besimin e partisë së tij në institucionin iranian të Velajetul-Fekih.

Pra, realiteti i negociatave që çoi deri në shkëmbimin e robërve, në realitet paraqesin negociata të mirëfillta izraelito-iraniane.

Cili është sekreti i kësaj kontradikte: kërcënim dhe përgatitje për sulm në njërën anë dhe në të njëjtën kohë negociata dhe shkëmbim robërish nga ana tjetër?

Raportet iraniano-izraelite shkaktojnë shumë përshtypje dhe paradokse. Në rrafshin e deklaratave, që nga revolucioni i vitit 1979 gjuha e zyrtarëve iranianë është e mbushur me termat: armiku izraelit, punë për të shkatërruar Izraelin, çlirimi i Kudsit, Jerusalemit dhe manifestimet e mëdha që bëjnë në këtë drejtim. Mirëpo të gjitha këto nuk e kalojnë kufirin e përkrahjes, solidarizimit deklarativ dhe fjalëve, kurse realiteti është krejt në kundërshtim me këtë. Për disa gjëra s'ka aspak dyshim dhe vend për koment, sikurse është fakti se Izraeli i ka shitur Iranit pjesë për armët e ushtrisë iraniane, që nga lufta irakiane-iraniane në vitet tetëdhjetë e deri më sot!

Në kohën kur Amerika bën presion dhe nxit koalicione për një bllokadë ekonomike ndaj Iranit, përvidhen raporte gazetareske se Izraeli importon nga Irani sasi shumë të

“...Fundamentalizmi shiit është i ngjyrosur me ngjyra persiane, i cili ngrihet mbi parimin e urrejtjes së arabëve...”

mëdha fëstëku iranian, vlera e të cilave arrin në njëzet milionë dollarë. Ky lajm vjen nga revista “El-Vatan El-Arabi”.

Para disa javësh qeveria zvicerane zbuloi edhe një turp tjetër të ri, e ajo ishte importimi i naftës iraniane nga ana e Izraelit.

Përveç bashkëpunimit ekonomik, Irani eksporton edhe hebrenjtë e vet për në Izrael për ta ndihmuar shtetin hebre në konfliktin e tij demografik, që ka me palestinezët. Me shtatë janar të këtij viti kanë zbritur në aeroportin Ben Gurion, në Izrael dyzet hebrenj me origjinë iraniane, si pjesë e një fushate shumë sekrete, të cilën e realizon një agjenci hebraike në bashkëpunim me një organizatë ndërkombëtare për miqësi krishtero-çifute, të cilën e drejton rabini Jeshail Aktashen.

Gazeta saudite “El-Vatan” duke u mbështetur në burime zyrtare izraelite citon: “Dyqind çifutë iranianë janë shpërngulur këtë vit në Izrael, kurse në vitin 2006 gjashtëdhjetë e pesë, kurse numri i përgjithshëm i hebrenjve që kanë emigruar nga Irani në Izrael, që nga viti 1948 është 77,833 persona”.

Kështu këto informata jozyrtare kanë zbuluar sasinë e bashkëpunimit ekonomik mes këtyre dy shteteve “armike”, edhe pse ka një bllokadë ekonomike ndaj Iranit, sasinë e përkrahjes së Izraelit duke lejuar emigrimin e hebrenjve nga Irani në Izrael, në kohën kur zyrtarët izraelitë japin deklarata për domosdoshmërinë e mos-dhënies dritë jeshile për programin bërthamor të Iranit dhe deklaratat e zyrtarëve iranianë, që flasin për domosdoshmërinë e shkatërrimit të Izraelit, e

gjitha kjo i sjell në mëdyshje të madhe të gjithë ata që nuk e kuptojnë politikën dhe kulisat e saj.

Ata që habiten me qëndrimin iranian nuk e dinë se fundamentalizmi shiit, ku mbështetet ky qëndrim ndërtohet mbi disa parime bazë:

Fundamentalizmi shiit është i ngjyrosur me ngjyra persiane, i cili ngrihet mbi parimin e urrejtjes së arabëve, për shkak se ata janë përgjegjës për shembjen e perandorisë persiane, prandaj duhet të bashkëpunojnë me armiqtë e tyre për të shkatërruar shtetin e tyre, për të dominuar me thesaret e tyre, duke i humbur forcën dhe rezistencën, që të dobësohen nga ana strategjike, madje ata disa herë janë mburrur se po mos të ishte ndihma e tyre dhënë SHBA-së, nuk do të binte Bagdadi dhe Kabuli. Sipas kësaj shihet qartë se Irani ka luajtur një rol të rëndësishëm në rënien e dy fuqive të rëndësishme dhe strategjike në rajonin arab dhe islam.

Parimi i dytë është **parimi i tukjes**, parim i cili është bazë në besimin shiit. Sipas tij, shiitët shfaqin të kundërtën e asaj që kanë brenda. Po sipas këtij parimi është edhe shfaqja në formën e atij që i mbron vendet e shenjta të muslimanëve dhe në rolin e mbrojtësit të Aksasë e Kudsit, jo vetëm që është demagogji politike, të cilën e bëjnë edhe kryetarët arabë, por edhe pjesë e ideologjisë shiite, e cila ndërtohet mbi parimet e mashtrimit dhe të gënjeshtërs.

Ai që ka ndonjë mëdyshje rreth qëndrimit izraelit ndaj Iranit duhet të kuptojë mirë, se parimi bazë mbi të cilin mbështetet politika izraelite, është ky që vijon:

Strategjia e shtrëngimit të palëve. Izraeli e konsideron Iranin prej shteteve palë. Në një studim me titull **“Shteti sionist dhe principi i provokimit të palëve”** studiuesi Dr. Semir Hajri e përkufizon principin e shtrëngimit të palëve duke thënë:

“Është një forcë politike e caktuar, shtet ose koalicion i disa shteteve, ose forcë

rajonale, që gjatë lëvizjeve karshi armikut, shfrytëzon disa pjesë përbërëse të këtij armiku dhe e tejkalon përfytyrimin tradicional të vlerësimit të forcës së tij. Kjo do të thotë se këto pjesë përbërëse krijohen ose formohen nga pala që e shfrytëzon këtë parim për të shtuar dobësimin e mundësive të palës tjetër në konflikt. Ky shfrytëzim konsiderohet një pjesë e parimit të lëvizjes gjithëpërfshirëse në ballafaqimin strategjik me armikun, sepse sot ai nuk përqendrohet në përbërësit e zakonshëm apo tradicionale të ballafaqimit, sikurse janë forca ushtarake, mundësitë ekonomike e përparimi teknologjik, por e kalojnë vlerësimin e të dhënave të tyre në një spektër tjetër, nëpërmjet të cilit mund të shkaktojë defekt apo dobësim të madh të forcës së armikut. Manifestimet e këtij drejtimi janë të shumta dhe të llojllojshme, mirëpo rezultati i përcaktuar dhe larg bashkëveprimit me komponentët tradicionale në forcën e armikut personifikohet në përfshirjen dhe lëvizjen e këtyre komponentëve shtesë, të cilën e përfaqëson dhe e shpreh në mënyrën më të mirë parimi i shtrëngimit të palëve”.

Ky parim shkakton angazhimin e palës së synuar në procesin e konfliktit dytësor. Ai i thërrmon shoqëritë kombëtare dhe krijon antagonizma mes mundësive që ofron një tërësi kombëtare, apo mundësive që ofron shteti dhe kështu me këto preokupime i largon nga pala kryesore në konflikt, i cili e ka përdorur parimin e shtrëngimit të palëve për interesin e tij.

Pikërisht këtë paraqet Irani për Izraelin. Ai është një krah i trekëndëshit të palëve që e rrethojnë botën arabe, kurse dy krahët e tjerë janë Etiopia dhe Turqia. Prandaj për sa kohë që këto palë bashkëpunojnë me armiqtë e umetit, umeti do të jetojë në bllokadë, sikurse është rasti edhe tani. ■

Përshtati: Bekir Halimi



DALLIMET E BESIMIT NË MES SUNIVE DHE SHIITËVE

Sot në trojet shqiptare ka interesa të caktuara nga qarqe të ndryshme, që kërkojnë të ndryshojnë raportet shekullore të Islamit shqiptar. Në mes tyre janë edhe shiitët e ardhur nga Irani,

SHKRUAN: ISMAIL TOPULLI

Sektarizmi, armiku më i keq për muslimanët shqiptarë

Muslimanët shqiptarë tradicionalisht i përkasin Islamit sunit, që nga ardhja e Islamit në trojet shqiptare e deri më sot. Sunitët përbëjnë pjesën dërmuese të muslimanëve në të gjithë botën, mbi 80 % e tyre, dhe vetëm një pakicë u përkasin sekteve dhe rrymave jashtë sunizmit. Nga këto sekte në pakicë, sekti që ka numrin më të madh të pasuesve, që nuk i përkasin sunizmit, është shiizmi. Ky sekt ka një shtrirje të kufizuar gjeografike. Ai gjendet me shumicë në Iran, Irak dhe Liban, ndërsa me

pakicë në disa prej vendeve arabe si edhe në Pakistan e Indi. Në mesin e shqiptarëve tradicionalisht nuk ka ekzistuar ndonjëherë ndonjë traditë e mirëfilltë shiite dhe për rrjedhim, nuk do t'ia vlente të trajtoheshin tema për tolerancë ndërsektare, siç mund të thuhej për shembull për ndonjë vend tjetër, si Iraku a Libani. Sot në trojet shqiptare ka interesa të caktuara nga qarqe të ndryshme, që kërkojnë të ndryshojnë raportet shekullore të Islamit shqiptar. Në mes tyre janë edhe shiitët e ardhur nga Irani, të cilët nën emrin e fondacioneve të tilla si “Saadi Shirazi” apo “Fondacioni i Kuranit” etj., kërkojnë të shiitizojnë Islamin shqiptar dhe ta bëjnë atë një kopje të variantit revolucionar iranian.

Ata, duke mos gjetur një traditë shiite mes shqiptarëve janë duke u munduar të përdorin si platformë për propagandën e tyre edhe tarikatet sufiste shqiptare. Veç kësaj, duhet thënë se ata janë duke përfutur edhe nga papërgjegjshmëria e theksuar fetare që shfaqin edhe drejtues të Komunitetit Musliman, të cilët s'e kanë për gjë t'i hapin dyert e bashkëpunimit kësaj propagande të rrezikshme jo vetëm për mbarëvajtjen fetare, por edhe për interesat tona kombëtare. Përhapja e sektit shiit në mesin e sunijve shqiptarë do të rezultonte me pasoja tepër të dëmshme në të ardhmen e afërt ose të largët për vetë Islamin shqiptar. Ne shqiptarët suni duhet të jemi të ndërgjegjshëm për aktualitetin tonë dhe nuk duhet të heshtim para këtij realiteti të ri, që shfaqet në formën e botimit të librave, simpoziumeve, gazetave dhe revistave, që bëjnë propagandë të hapur apo të fshehtë shiite. Për më tepër shiitët po ribotojnë librat e hoxhallarëve shqiptarë të traditës sunite për t'u popullarizuar e faktorizuar në mjedisin shqiptar, duke përdorur si pasaportë lejen publike të Komunitetit Musliman. Lejet publike për "përvetësimin" e trashëgimisë fetare sunite, ashtu si edhe lajmet se Komuniteti Musliman u ka dorëzuar organizatave iraniane administrimin e një shkolle fetare (medreseje) apo ndërtimin e disa xhamive, bien ndesh me pretendimet se Komuniteti Musliman interesohet për mbarëvajtjen dhe ruajtjen e Islamit tradicional dhe harmonisë fetare në vend, kur në fakt po ndihmojnë rrënjosjen e strukturave të një sekti të huaj për traditën dhe të rrezikshëm për harmoninë fetare, sekt që instrumentalizohet nga një shtet revolucionar dhe luftënxitës si Irani. Shpresojmë që drejtuesit e sotëm të Komunitetit Musliman do ta kuptojnë në kohën e duhur këtë rrezik dhe do të jenë në lartësinë e detyrës që kanë marrë përsipër, për të ndërprerë sa më parë bashkëpunimin

me organizatat iraniane, bashkëpunim që e kemi trashëgim nga vitet e turbullta të tranzicionit e për të cilin ata nuk janë përgjegjës.

Meqë shiitët e Iranit sot janë faktor në politikën botërore, interesi mbarëislam, sipas disave, e do që të bashkëpunohet me ta, mirëpo kjo nuk do të thotë që edhe ne si shqiptarë t'u hapim atyre dyert, madje edhe atë të mundësimit që sunijnjtë shqiptarë të konvertohen në shiitë! Ne shqiptarët duhet të jemi më realistë për fatet e Islamit tonë lokal, dhe nuk duhet të na duket vetja se kemi ndonjë rol në arenën ndërkombëtare, e për rrjedhim u dashka të përfshihemi në ato lëvizje dhe ide, që kërkojnë bashkime shiite-sunite! Të tillë 'internacionalizma' vetëm se do të favorizonin kushtet për shtimin numerik të shiitëve mes shqiptarëve dhe për rrjedhojë, mbas njëfarë kohe relativisht të gjatë apo të shkurtër do të shikonim se si mes nesh do të rritej një minorancë e konsiderueshme shiitësh, të cilët sado vëllazërorë që të jenë do të krijojnë probleme të natyrës përçarëse mes muslimanëve shqiptarë, përçarje, e cila do të na sillte të tilla probleme, të cilat askush nga ne nuk i dëshiron. A nuk na mjaftojnë problemet e shumta që ne kemi, por duhet t'u hapim derën edhe halleve të tjera në të ardhmen?! Armiqtë e Islamit të trojeve shqiptare janë të shumtë dhe nuk do të lënë rast që t'u ikë nga dora, me qëllim që të na dëmtojnë në çdo kohë, e të gjithë e dimë sesa lehtë shfrytëzohet arma e sektarizmit dhe për këtë kemi shembull të gjallë Irakun.

Bashkësitë Islame Shqiptare ashtu si edhe mjaft individë me zë në mes suninjve shqiptarë janë të vetëdijshëm për dallimet serioze mes suninjve dhe shiitëve, por e keqja është se ata mendojnë që edhe muslimanët e thjeshtë janë të imunizuar dhe të ndërgjegjshëm për këto ndasi dhe ndoshta mendojnë, se ata nuk do të bien pre' e

propagandës shiite! Gabimi i tyre është i dyfishtë: nga njëri krah ata nuk luajnë një rol aktiv në mbrojtjen e doktrinës sunite, kundrejt asaj shiite, dhe në krahun tjetër me heshtjen e tyre, ndonjëherë edhe me deklaramet dhe qëndrimet e tyre luajnë rolin e pro-shiizmit pasiv. Kjo duket qartë në bashkëpunimin që Bashkësia Islame Shqiptare kryen p.sh. me “Fondacionin e Kuranit”, një fondacion shiit ky i financuar nga Irani, një shtet i cili, jo vetëm në aspektin fetar vazhdon traditën e tij të hershme të asimilimit të suninjve, por edhe në aspektin politik është kundërshtar indirekt i interesave kombëtare shqiptare.

Historia e afërt e vendeve të tilla si Iraku apo Libani, na tregon mjaft qartë se si po i shkatërron këto vende ndasia sektare mes sunive dhe shiitëve. Ndaj, ne duhet të jemi më të vetëdijshëm për rreziqet që na kanosen si muslimanë shqiptarë, jo vetëm në të ardhmen e afërt, por edhe në atë të largët. Ruajtja e unitetit doktrinar për ne muslimanët shqiptarë është jetike.

Çfarë besojnë shiitët ndryshe nga suninjtë?

Shiitët janë një sekt që pretendojnë se Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, kushëriri i Profetit, paqja e Allahut qoftë mbi të, dhëndri i tij, një nga muslimanët e parë dhe një nga miqtë e tij më të afërt është i vetmi që gëzonte të drejtën për të trashëguar udhëheqjen politike dhe fetare të muslimanëve, ose siç njihet ndryshe, Kalifatin. Për këtë arsye, për shiitët, Ebu Bekri, Omeri dhe Osmani, Allahu qoftë i kënaqur me ta, janë grabitës dhe

uzurpatorë të kësaj pozite!¹ Madje shumë prej tyre kanë shkuar deri atje sa t'i konsiderojnë ata dhe të gjithë muslimanët, që ua njohin këtë pozitë historike dhe fetare, si jomuslimanë!² Shiitët e kanë shndërruar Kalifatin fetar apo ndryshe Imametin (prijësinë fetare), si një nga çështjet themelore të besimit të tyre. Sipas tyre, Profeti, paqja e Allahut qoftë mbi të, ka caktuar me urdhër të Allahut, që Aliu dhe dymbëdhjetë pasardhës të tij do të jenë Imamë për muslimanët për t'i udhëzuar ata në rrugë të drejtë.³ Çuditërisht përveç Aliut dhe djalit të tij Hasanit, asnjë nga pasardhësit e tjerë, të cilët ata i konsiderojnë si imamë, nuk kanë pasur postin e Kalifit! Për këtë edhe shiitët janë detyruar të pohojnë se ata ngelen prijës pavarësisht se nuk morën pushtet politik, ndonëse sipas tyre vetëm atyre u takonte! Ata besojnë se i dymbëdhjeti prej këtyre imamëve, i cili sipas disa burimeve shiite, as që ka lindur fare është futur në një qilar në Samara (në Irak), që në moshë të vogël dhe prej aty është zhdukur dhe jeton edhe sot e kësaj dite, mbas qindra vjetësh, i fshehur për të dalë një ditë dhe për të marrë frenat e Kalifatit në dorë!⁴ Shiitët, ndryshe nga suninjtë besojnë se këta imamë janë të pagabueshëm, si Profeti, paqja qoftë mbi të, dhe si engjëjt.⁵ Shiitët besojnë se imamët e tyre kanë grada më të larta se engjëjt dhe Profetët.⁶ Ata shkojnë deri atje sa t'u luten këtyre njerëzve dhe të besojnë se ata janë ndërmjetës në mes njerëzve dhe Allahut.⁷ Ky është shirk (t'i bësh Zotit ortak në adhurim) dhe Allahu e ka ndaluar rreptësisht këtë gjë, Ai thotë: **“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet**

¹ “Bihar el-Enuar” te komenti i ajetit 25, Sure El-Enfal, po ashtu v.101 fq. 107. etj. (arab). **Për shiitët është i njohur mallkimi dhe sharja që ata i bëjnë në veçanti Ebu Bekrit dhe Omerit, si për shembull në atë që quhet “Duaja ndaj dy idhujve të kurejshëve” ku nënkuptojnë këta dy sahabel** (shih “Nefehat el-lahut” e Kerekit, “Fi miraatul ukul” 4/356 e Mexhlisit...etj). **Gjithashtu edhe libri “Shtegu i elokuencës”, që padrejtësisht i atribuohet Aliut, përmban akuza të pavërteta ndaj shokëve të tjerë të Profetit!**

² “Tefsir el-kumij” te komenti i ajetit 40, Sure El-Araf, Hashijetu el-amili ala bejdaui, te komenti i ajetit 74 Sure Et-teube, Elenuar en-numanije vol. 2, fq. 278 etj.

³ Shih “Ç’është Islamizmi” i Ajetullah Imam Es-sejid Muhamed El-Shirazi fq. 35. Libër shiit i përkthyer nga Vullnet Merja, drejtues i “Fondacioni i Kuranit”.

dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim etj), ka bërë gjynah të tmerrshëm.⁸

Ky sekt, një pjesë të madhe të veprimtarisë fetare të tij ia kushton lavdërimit të këtyre njerëzve, varreve të tyre, që i konsideron si vende të shenjta, vajtimit për vdekjet e tyre dhe mallkimit të atyre, që ata i konsiderojnë si kundërshtarë fetarë të këtyre imamëve.⁹ Por ekstremizmi i ithtarëve të këtij sekti nuk ndalet me kaq. Ata për çdo vit në Ditën e Ashures përkujtojnë vrasjen e nipit të Profetit, Hysenit, me rituale gjakatare, duke masakruar veten e tyre, madje edhe fëmijët e vegjël, me zinxhirë e kama, si shfaqje e hidhërimit për vdekjen e tij! Dhe skena të tilla makabre

shfaqen çdo vit nëpër televizionet e botës, sa herë që vjen dita e Ashures! Një ritual i tillë jo vetëm që nuk gjen aspak mbështetje në fenë tonë, por një mynxyrë e tillë është kategorikisht e ndaluar dhe tërësisht e dënueshme.¹⁰

Një tjetër dallim shumë i rëndësishëm në mes të shumicës së muslimanëve dhe shiitëve është edhe besimi në ruajtjen e Kuranit. Në librat bazë të besimit shiitë, si dhe në disa dhjetëra thënie të dijetarëve të tyre të hershëm, konstatohet se shiitët nuk besojnë se Kurani është ruajtur ashtu siç na e ka lënë Profeti, salallahu alejhi ue selem, por ai është ndryshuar nga shokët e Profetit, salallahu alejhi ue selem, dhe nga të tjerët më pas! Për këtë ata japin edhe shembuj të shumtë!¹¹ Këtë

⁸ “Ç’është Islamizmi” fq. 38. Kjo doktrinë është kaq e përhapur në mes shiitëve, saqë janë shkruar shumë libra që flasin për këtë imam të humbur, si “El-gijbetu” (mungesa) e En-Numanit, “El-gijbetu” e Et-Tusit etj.

⁹ “Ç’është Islamizmi” fq. 27, fq. 36.

⁶ ‘El-hukumu El-islamijetu’ i Homejnit fq. 93, botimi i dytë.

⁷ ‘Misbahul hidaje ilet hilafeti uel uilaje’ në fq. 145

⁸ Sure En-Nisa: 48.

⁹ “Ç’është Islamizmi” fq. 93-97, 109, “Masakra e Kerbelasë” fq. 59-63, etj.

¹⁰ Shih sure El-Bekare: 195, El-Maide: 6, El-Haxh: 78., hadithin 32 tek “Dyzet hadithet e Neveviut”.

¹¹ Ja disa referenca shiite për këtë: El-kulejni në librin ‘Usul min El-kafi’ v. i parë fq: 412-414, 416, 417, 418, 421-424, 429, 432-434 botimi i katërt v. 1392 h/1972 e.s), Elmufid në ‘Euail el-mekalat’ (fq. 13, 54 botimi i dytë 1379h/1959e.s.) si dhe në librin ‘El-ihhtisas’ (fq. 123 botim Mektebetu besireti Kum pa datë botimi), El-Kumi në komentin e tij të Kuranit në hyrje (fq. 10) dhe vende të tjera (shih volumni i parë faqe: 29, 48, 58, 79, 100, 109, 110, 136, 141, 142, 196, etj. volumni i dytë faqe: 35, 111, 125. botim i dytë Kum 1968 e.s), El-Kashani në komentin e tij të Kuranit ‘Es-safi’ në hyrjen e gjashtë (fq. 24-37), si dhe shumë ajete të ndryshuara sipas tij (shih volumni i parë faqe: 96, 114, 118, 182, 183, 202, 257, etj. botim Kitabfrushi islamijetu, Iran, pa datë botimi), El-Bahrani autori i komentit ‘El-burhan’ (shih volumni i parë faqe: 50, 102, 104, 125, 129, 130, 140, 170, 208, 231, etj. botimi i dytë, Iran), Et-Tabersi në librin ‘El-Ihtixhaxh’ (volumni i parë fq. 223-228, botim Fondacioni En-Nu’mān, Bejrut, pa datë botimi), El-Xhezairi në librin ‘El-enuar en-numa’nije’ (vol i parë fq. 97, dhe i dytë fq. 357, botim 1378 h./1958 e.s. Tibriz), El-Mexhlisi në librin ‘Tedhkiretu el-eimetu’ (fq. 9), në librin ‘Hajat el-kulub’ (vol. 2 fq.681) dhe në librin ‘Mir’atu el-ukul’ (vol. 12 fq. 525 botim 1400h./1980 e.s. Iran) në këtë libër ai madje është i mendimit se transmetimet që flasin për deformimin e Kuranit janë kaq të shumta, dhe se mohimi i tyre do të thotë të mohosh edhe transmetimet e *imametit*, e që për shiitët është thelbi i Islamit! Mirza Husejn En-nuri Et-Tabersi në librin e tij të famëkeq ‘Fasl el-khitab fi ithbat tahrif kitab rabi el-erbab’ Libër në të cilin autori i tij ka mbledhur me qindra thënie nga dijetarët shiitë dhe muxhtehidët e tyre nëpër shekuj, se Kurani është ndryshuar!!! Libër që u botua në Iran në vitin 1298 h./1881 e.s., i cili duke qenë se është pak a shumë i vonshëm, vetëm një shekull e ca më parë, kohë kur shiitët ishin të mendimit se një gjë e tillë duhet mohuar për ta, ashtu siç bëjnë edhe sot shkaktoi një zhurmë të madhe në mes vetë shiitëve, disa prej të cilëve e kundërshtuan. Por autori në fjalë jo vetëm që nuk hoqi dorë, por vetëm dy vjet para se të vdiste nxori një libër tjetër me titullin ‘Redu badu eh-shubuhāt an ‘Fasl el-khitab fi ithbat tahrif kitab rabi el-erbab’, ku mbron qëndrimin e tij në librin e parë. Madje edhe ky, si El-Mexhlisi është i mendimit se transmetimet që flasin për deformimin e Kuranit janë të shumta dhe se mohimi i tyre do të thotë të mohosh edhe transmetimet e *imametit*, gjë që shiitët nuk mund ta bëjnë!

“...Shiitët, ndryshe nga suninjtë besojnë se këta imamë janë të pagabueshëm, si Profeti, paqja qoftë mbi të, dhe si engjëjt...”

doktrinë ata e kanë ruajtur për shekuj me radhë, siç dëshmojnë edhe vetë librat e shiitëve, por sot ata e mohojnë që një gjë e tillë të ketë qenë besimi i tyre! Por kjo është vetëm një përpjekje për të fshehur të vërtetën, karshi muslimanëve të tjerë, pse jo edhe ndaj ndjekësve të thjeshtë të shiizmit. Ndaj edhe deklarimet, edhe aktivitetet e tyre, që pasqyrojnë të kundërtën e këtij besimi që kanë trashëguar janë një maskë, për vetë faktin se një nga pikat e besimit të tyre është edhe fshehja e doktrinë shiite, apo e pjesëve të saj karshi atyre që nuk janë shiitë, kjo jo vetëm kur rrezikohen, por edhe për qëllime propagandistike.¹²

Veç këtyre dallimeve doktrinale, shiitët dallojnë me shumicën e muslimanëve edhe në një pjesë të praktikave fetare, si në thirrjen e ezanit, marrjen e abdesit, faljen e

namazit etj.¹³ Po ashtu edhe në disa çështje sociale, siç është lejimi që ata i bëjnë martesës së përkohshme, gjë që ka shkaktuar probleme sociale me fëmijët që lindin nga këto “martesa”, në vendet shiite ku është e përhapur më së shumti kjo praktikë.¹⁴

Këto janë disa prej dallimeve kryesore në mes shumicës së muslimanëve dhe shiitëve, ku për çdonjërin prej tyre kemi përmendur burime nga literatura e tyre, disa prej tyre edhe në shqip.¹⁵

Duhet të theksojmë se vërtetësia e doktrinës sunite mbështetet tërësisht në Librin e Zotit, Kuranin, si dhe në traditën autentike, që muslimanët kanë trashëguar nga Profeti i Zotit, traditë kjo e ruajtur me fanatizëm në mënyrë të pandërprerë për katërmbëdhjetë shekuj me radhë. Është pikërisht kjo traditë që shprehet në mënyrë të qartë, se e vërteta e Islamit do të mbetet gjithmonë brenda grupimit të shumicës së muslimanëve.¹⁶ Kjo shumicë, përherë dhe kahmoti u përket muslimanëve suninj! E lusim Zotin t’i udhëzojë të gjithë muslimanët! ■

¹² El-Kulejni në “El-Kafi”, një kapitull i tërë për fshehjen e besimit (tekijes) “Kapitulli i Tekijes”, Khomeini në “Keshf El-Esra” fq. 129... etj.

¹³ Në ezan ata shtojnë shprehjen se “Aliu është miku i Allahut” dhe “ejani në punë të mira” një risi (bidat), që nuk i përket traditës profetike. Gjatë abdesit nuk i lajnë këmbët (edhe nëse janë të zbathura), por vetëm i prekin me dorë të lagur, si kokën, ndërsa mes’hin mbi meste ose çorape nuk e lejojnë. Në namaz ata preferojnë të bien mbi sexhde mbi një copë baltë të pjekur nga dheu i Qerbelasë, nuk japin selam, por rrahin me duar kofshët... si dhe shumë bidate të tjera.

¹⁴ Nuk ka ndonjë kohëzgjatje të caktuar të kësaj “martese” te shiitët, ajo mund të jetë edhe një ditë apo një orë! Në këtë “martesë” detyrimi financiar karshi “bashkëshortes” është i reduktuar. Shih. El-Furu të Kulejnit, si dhe çdo libër tjetër, ku trajtohen çështjet e fikut.

¹⁵ Për informacione më të hollësishme mund të vizitoni forumin <http://groups.yahoo.com/group/alb-muslim-students>.

¹⁶ Shih “Sunen Ibn Maxhe” nr. 3992, “Sunen Ebu Daud” nr. 4596, “Xhamiu Tirmidhi” nr. 2640, “Sunen Nesai” etj. Po ashtu për thëniet të tjera të Profetit, që mbështesin këtë doktrinë “Sahih Buhari” nr. 6881, “Sahih Muslim” nr. 1921 etj.

KRIZË E MJETEVE APO KRIZË E SYNIMIT



Ne nuk kemi kanal satelitor islam, që të shquhet me një tërheqje dhe atraksion të madh. E njëjta gjë vlen edhe për radiot dhe mediat e shkruara, ku revistat dhe gazetat islame kanë tirazh të ulët, ndërsa niveli profesional i shumicës së tyre sillet nga ai mesatar në atë të dobët.

ABDULKERIM BEKKAR

Sa herë që takohet një grup njerëzish që janë të preokupuar me çështjen e davetit dhe udhëzimit të tjerëve në rrugën e drejtë, nuk ndodh e të mos sillet në mesin e tyre biseda, diskutimi dhe ankesa rreth pamundësisë së thirrësve për të zotëruar instrumentet e davetit, ku përmes të cilave do ta realizonin përhapjen e kauzës së tyre dhe do t'i bënin të njohura për të tjerët fjalët, parimet dhe kriteret e tyre.

Ne nuk dëshpërohem kur krahasojmë

prapambetjen e instrumenteve tona dhe instrumenteve të avancuara që zotërojnë të tjerët, të cilët janë rivalët dhe kundërshtarët tanë. Dhe për këtë në shumicën e rasteve nuk gabojmë dhe nuk e teprojmë. Padyshim çështja e davetit vuan qartë nga mosekzistimi i mjeteve, që do të kishim mundësi t'i përdornim në kumtimin dhe përhapjen e shpalljes hyjnore, Islamit. Ne nuk kemi kanal satelitor islam, që të shquhet me një tërheqje dhe atraksion të madh. E njëjta gjë vlen edhe për radiot dhe mediat e shkruara, ku revistat dhe gazetat islame kanë tirazh të ulët, ndërsa niveli

profesional i shumicës së tyre sillet nga ai mesatar në atë të dobët. Kjo çështje në shkallë të lartë nuk ndryshon as tek hutbeja e xhumasë. Ligjëruesit, të cilët kanë aftësi për t'i përcaktuar diagnozat reale të gjendjes së muslimanëve dhe më pas për të përshkruar ilaçet për këtë gjendje janë të pakët. Përkundër kësaj gjendje është shumë e rëndësishme t'i kuptojmë shkaqet thelbësore të atyre fenomeneve dhe problemeve që i shohim dhe të atyre që shfaqim pakënaqësi, sikurse janë krizat dhe të pakëndshmet. Prapambetja e muslimanëve dhe neglizhenca e asociacioneve të tyre të ndryshme padyshim që do të reflektohen në të gjitha mjetet, instrumentet dhe mekanizmat, që kanë ata para duarve të tyre në të gjitha poret e jetës. Kjo nuk është arsyeja kryesore, e cila ka ndikuar në ngecjen e mekanizmave të dëvetit, por shkak themelor qëndron në atë se shumica e thirrësve nuk zotërojnë synime të qarta gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre sistematike. Synimi i lartë, i qartë dhe i studiuar mirë e krijon vetvetiu mjetin që i stimulon pastaj ata që e kanë kristalizuar atë në zbulimin e instrumenteve dhe mekanizmave të tjerë, që do t'i çojnë drejt realizimit të këtij synimi. Shumica e synimeve në dëvet nuk e realizojnë një gjë të tillë, për arsye se nuk i përmbushin tiparet e synimit të lartë. Thirrësi këtë e percepton në mënyrë të zbehtë, që rezulton më pas me humbjen e cilësisë së inkurajimit, të cilin e sqaruar më lart.

Atëherë mund të konkludojmë lirisht, se kriza jonë kryesore qëndron në mosekzistimin e objektivit të lartë e jo në moszotërimin e instrumenteve dhe mjeteve të suksesshme. Kriza e objektivit të lartë është rezultat i plogështisë individuale të çdonjërit nga ne, prej së cilës dëveti vuan për një kohe të gjatë. Kjo amulli shfaqet në

“Disa aktivistë që veprojnë në thirrjen në rrugë të Allahut janë me të vërtetë mediokër. Ata nuk shikojnë larg...”

mediokritetin për të kuptuar veprimtarinë e duhur, për t'i udhëzuar dhe për t'i përmirësuar njerëzit, si dhe për të përcaktuar mënyrën dhe llojin e mesazhit që duhet formuluar në tërë këtë proces dhe për t'iu drejtuar atyre. Prej kësaj rezulton mosekzistimi i forcës për t'i përcaktuar objektivat, ku të gjitha mundësitë dhe kapacitetet tona duhen drejtuar nga ato. Kjo pastaj i shtyn njerëzit të veprojnë në të gjitha drejtimet, të merren dhe të preokupohen me çdo gjë në të gjitha drejtimet, mirëpo pa arritur ndonjë sukses në asnjë aspekt.

Në çastin kur zotërojmë një synim të lartë do të kemi mundësinë të zotërojmë mjetet e duhura, mirëpo në çastin kur nuk e kemi këtë synim, kurrë nuk do të kemi mundësinë t'i njohim mekanizmat e përshtatshëm dhe nuk do t'i zotërojmë ato.

Nëse meditojmë rreth kursit të reformatorëve të mëdhenj, që ndryshuan rrjedhën e historisë islame do të vërejmë se shumica prej tyre, apo më mirë të themi, që të gjithë në fillim të fushatës nuk zotëronin asnjë mekanizëm të sofistikuar dhe asnjë instrument efektiv për t'i përhapur idetë e tyre dhe për të përmirësuar realitetin. Mirëpo ajo që vërejmë është se ata e dinin shumë qartë se çfarë dëshironin, çështjet për të cilat ata punonin për t'i arritur iu shfaqeshin kthjellët në horizont. Nuk ndryshon pozita e reformatorëve tanë me ata të popujve të huaj. Çifutët vuanin në njëfarë mënyre nga bojkoti botëror i

shoqëruar në njëfarë mase nga disa shtete edhe me persekutim. Në fund të shekullit të 19 mbliidhen në Zvicër “elita” e tyre dhe merren vesh për një synim madhor, që pas 50 viteve në tokë të huaj, Palestinë të formojnë shtetin e tyre. Ai që i shikonte mundësitë e tyre të pakta që ata zotëronin në atë kohë dhe vështirësitë e mëdha për të realizuar atë synim madhor në kohën e Perandorisë Osmane, çuditet nga kjo aspiratë e pazakontë. Mirëpo puna serioze, zelli i madh dhe ngulmi i tyre për të arritur këtë objektiv të qartë dhe konkret, që për nga natyra e tij vetvetiu krijoi shumë rrethana të volitshme, bëri që ajo me të vërtetë edhe ndodhi.

Disa aktivistë që veprojnë në thirrjen në rrugë të Allahut janë me të vërtetë mediokër. Ata nuk shikojnë larg dhe nuk janë në gjendje të reflektojnë rreth rezultateve të shumë çështjeve madhore. Kjo i privon ata nga perceptimi për të vërejtur se cilat janë mundësitë, favorët dhe kufizimet. Për këtë arsye ata gjithmonë preokupohen me gjëra të konsumuara dhe të thjeshta, duke menduar se këto janë të qëndrueshme dhe të përhershme. Përparimi shkencor dhe teknik, i cili po ndodh kohët e fundit e ka shndërruar normën kryesore të jetës në lëvizje dhe ndryshim e jo në palëvizshmëri dhe qëndrueshmëri.

Ka njerëz që merren me kauzën e davetit, dhe shquhen me aktivitete të shumta, ndërsa çështjen e organizimit, planifikimit, vendosjes së strategjive dhe kristalizimin e objektivave e konsiderojnë si humbje kohe, dhe se kjo nuk ka arsye të ekzistojë. Kjo sipas këndvështrimit të tyre është formë e ikjes nga puna dhe e zhvendosjes së përgjegjësiave të mëdha. Ky lloj njerëzish është një kategori shumë e gjerë, deri në atë masë sa që nuk mund ta besosh.

Është për të ardhur keq nga ata që kritikojnë planifikimin dhe organizimin. Mirëpo në të njëjtën kohë ata nuk veprojnë asgjë dhe nuk japin kurrfarë rezultati, e shikuar kjo realisht ata vuajnë nga mosefikasiteti, mosveprimi dhe plogështia e plotë. Nëse i pyet se çfarë keni ofruar për këtë umet gjatë javës dhe muajit të kaluar, nuk kanë çfarë të përmendin. Ata që veprojnë pa vizion, pa objektiva konkrete dhe pa prioritete janë në një gjendje shumë më të keqe sesa mosvepruesit, për arsye se lëvizjet dhe aktivitetet e tilla të pamenduara rezultojnë në shpërthimin e katastrofave.

Për t’u realizuar synimi i mirë jemi të detyruar fillimisht të bëjmë plane, këto plane duhet doemos të përfshijnë; mundësitë, kohën e duhur, duke mos harruar edhe pengesat që mund të hasen. Vetëm në këtë mënyrë do ta gjejmë veten të detyruar në zbulimin dhe krijimin e mjeteve të efektshme dhe të përshtatshme.

Unë nuk bëj pjesë në grupin e atyre që thërrasin në realizimin e gjërave ideale dhe të pamundura, për shkak se problemi kryesor nuk fshihet në gjërat e pamundura që shpresojmë, por në ato që janë të mundura, ndërsa ne i kemi humbur!

O ju, që ua ka zënë frymën realiteti me prurjet e tij të rënda, dhe ju ka privuar nga shikimi i gjerë i horizontit që po ju pret. O ju, që jeni bërë kronikë me ankesat për mospasjen e forcës dhe moszotërimin e mjeteve... dhurojini vetes kohën e mjaftueshme për t’i eksploruar dhe për t’i gjetur synimet më të larta të mundura që keni pasion t’i realizoni, dhe do të bindeni se kjo do t’ua shndërrojë mjetet tuaja në më frytdhënëse dhe më reale. Kjo më pas do t’ua lehtësojë administrimin më të mirë të mundësive të kufizuara që keni para duarve tuaja. ■

Përktheu: Agron TERZIQI

MILINGONA

Ndoshta kush e ka parë dhe e ka lexuar titullin e kësaj teme është habitur, shumë vetë ndoshta me vete mund të kenë thënë: Përse një titull i tillë! Çfarë do të na flasë hoxha për milingonën!

PROF. DR. NASIR EL-OMER

Ndoshta kush e ka parë dhe e ka lexuar titullin e kësaj teme është habitur, shumë vetë ndoshta me vete mund të kenë thënë: Përse një titull i tillë! Çfarë do të na flasë hoxha për milingonën!

Ndërsa unë do të mundohem ta shuaj këtë habi dhe kureshtje, por më parë u drejtohem atyre që janë habitur: A nuk lexoni ju librin e Allahut? A nuk e shikoni sesi Allahu në të ka vendosur një sure, të cilën e ka emërtuar me këtë emër?!

“Kur arritën në Luginën e Milingonave, një milingonë tha: “O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë”! Neml, 18.

Padyshim se emërtimi i një sureje të tillë me këtë emër ka një domethënie dhe urtësi të madhe.

I nderuar lexues! Unë mendoj se kjo temë ka një rëndësi të veçantë dhe këtë e them pa e tepruar. Ai që e shikon jetën e këtij insekti; ai që lexon se ç’kanë thënë komentuesit për ajetin e milingonës, madje ai që njihet edhe me atë që kanë thënë zoologët për këtë insekt, nuk i mbaron habia asnjëherë rreth këtij insekti. Kështu që tema jonë, nuk do të jetë e përqendruar vetëm në



atë se çfarë është thënë për suren *Nemël*; por unë do ta filloj me të dhe padyshim që kjo është një temë shumë e gjatë.

Përse duhet të flasim pikërisht për Milingonën?!

Po, me të vërtetë ajo është një krijesë e vogël, porse: *“Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar”*. Taha, 50.

Milingona, nuk mund të them se ka një histori, por ajo ka shumë histori dhe Allahu në fillim ose në fund të këtyre historive ka thënë: *“Në tregimet e atyre ka këshilla për ata që janë me mend. Ky (Kuran) nuk është tregim i trilluar.”* Jusuf, 111.

Përse e kam zgjedhur këtë temë? E kam zgjedhur këtë temë sepse kam arritur në një përfundim dhe rezultat, të cilin dëshiroj ta arrijnë shumë prej muslimanëve.

Lexues i nderuar! Kur të lexosh në lidhje me hapin e parë të kësaj teme, dua prej teje një gjë të vetme. Krahajo veten dhe vëllezërit e tu me bashkësinë e milingonës! Nëse vërtet je realist, sigurisht që do të shohësh se ne vërtet jemi shumë larg nga kjo milingonë e vogël! Do të gjesh se milingona ka bërë aq shumë hapa përpara, sa që shumë prej nesh do të dëshironin që ta arrinin atë. Por le të fillojmë me atë që gjendet në Kuranin Famëllartë: *“Kur arritën në Luginën e Milingonave, një milingonë tha: “O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë”!* Nemël, 18.

Do të japim në lidhje me këtë ajet disa shkëndija dhe të mençurve i mjaftojnë disa shkëndija për të kuptuar urtësinë që përmban ajo.

“Kur arritën në Luginën e Milingonave”.

“...pyesim njëri-tjetrin: Çfarë bëri filan hoxha? Po filan dijetari çfarë bëri? Ndërsa unë të drejtohem ty, i nderuar vëlla musliman! Pasha Zotin më thuaj: ti çfarë ke bërë?...”

Përse u quajt ajo lugina e milingonave? U quajt kështu, sepse shumica e banorëve të saj ishin milingona. Kur Sulejmani alejhi selam, shkon me ushtrinë e tij në këtë luginë, shfaqet çështja. *“O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë”!*

Allahu Ekber! Në çastin që ajo ndjeu rrezikun e madh për kombin e saj thirri me të madhe: Po vjen rreziku. Shpëtoni veten tuaj që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë”

Sa madhështore kjo milingonë, ajo mbarti mbi shpinë merakun për kombin e saj, në çastin e rrezikut, ajo kuptoi përgjegjësinë e saj ndaj dhe thirri me të madhe: Po vjen rreziku. Shpëtoni veten tuaj.

Shikoje me vëmendje këtë milingonë, lexues i nderuar! A mos vallë ajo u largua duke vrapuar, që të shpëtonte veten? Mos vallë tha: Çfarë të bëj? Unë jam një milingonë e dobët, ç’të bëj përballë kësaj ushtrie gjigante?

Atëherë pyetja na drejtohet neve: Rreziku që i kanoset umetit tonë: a nuk është më i madh, sesa rreziku që i kanosej këtyre milingonave? Sa nga ne e ndiejnë atë që ndien kjo milingonë dhe përpiqet që ta shpëtojë umetin? Kush nga ne fle dhe zgjohet e mbart shqetësimin e

rrezikut, që i kanoset umetit majtas e djathtas? Vallë shqetësimi i umetit është në krye të listës së gjërave tek ne, apo është shqetësimi i pasurisë, shtëpisë e shqetësimi i umetit renditet andej nga fundi. Në realitet për të qenë të singertë me vetveten, të pakët janë ata që e vënë në krye të çdo shqetësimi, shqetësimin për umetin dhe rreziqet që i kanosen atij.

Të nderuar lexues! Ejani me mua të shohim përsëri në këtë ajet kuranor: **“një milingonë tha”**, Allahu këtu na e sjell milingonën në trajtë të pashquar, pra, ajo ishte një milingonë e zakonshme në atë luginë të gjerë, megjithatë ajo nuk e nënvleftësoi veten e saj, porse bëri atë që kërkohej prej saj; ndërsa ne shpeshherë pyesim njëri-tjetrin: Çfarë bëri filan hoxha? Po filan dijetari çfarë bëri? Ndërsa unë të drejtohem ty, i nderuar vëlla musliman! Pasha Zotin më thuaj: ti çfarë ke bërë? Ajo ishte një milingonë e vetme dhe shpëtoi një popull, ajo ishte vetëm një milingonë e përsëri ajo jetoj me shqetësimin e popullit të saj.

Vëllai im! Motra ime! Është shumë e lehtë t’ia ngarkosh përgjegjësinë e umetit të tjerëve, por le të jemi realistë dhe të guximshëm përpara të vërtetës: Ne çfarë kemi bërë?

Ajo ishte thjesht një milingonë dhe veproj gjithë këtë mirësi, ndërsa ti nuk po mundesh të kryesh atë që bëri kjo milingonë me popullin e saj?

Por le të qëndrojmë në pikën e fundit në lidhje me këtë ajet: **“O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë”!**

Mos vallë ajo u ul dhe po komentonte qëllimet dhe brendësitë? Mos vallë tha: Sulejmani po ju shpërfill, sepse ju jeni një ushtri e dobët? Jo, ajo e shfajësoi atë e tha: **“duke mos ju parë”** Edhe pse ajo u frikësua

se mos i shtypnin dhe i shfarosnin, përsëri i justifikoi: **“duke mos ju parë”**. Por eja e të shohim në realitetin tonë! Në mesin tonë gjen që i akuzojnë thirrësit dhe i vendosin epitete të ndryshme, disa i akuzojnë se duan pozitë; disa se duan dynjanë apo karrierën, ndërsa Profeti, salallahu alejhi ue selem, i thotë mikut të tij -Zejd-it-: **“A mos ia çave gjë gjoksit?”** Muslimi.

Ne sot po përpiqemi t’i çajmë zemrat njëri-tjetrit, ndërsa milingona ishte më e kujdesshme se ne në këtë aspekt. Ajo nuk i la shkak popullit të saj, që të fliste apo mendonte diçka për Sulejmanin.

Milingona i thotë këto fjalë, edhe pse ata mund t’i dëmtonin, po si i vete halli që ne i hapim zemrat e vëllezërve, ndërkohe që ata përpiqen për të mirën tonë. A mos vallë iu drejtuan milingonat shoqes së tyre duke i thënë, ti kërkon pozitë, apo pushtet? Jo nuk iu përgjigjën kështu, por menjëherë e dëgjuan thirrjen e saj dhe hynë në strofkat e tyre.

Nga cilësitë e milingonës, është durimi dhe këmbëngulja.

Milingona është e habitshme në durimin dhe vendosmërinë e saj, ah, sikur ndonjëri prej nesh ta kishte durimin dhe vendosmërinë e milingonës, qoftë për të mësuar fenë e Allahut, qoftë në thirrjen e njerëzve në këtë fe.

Meditoni për jetën që bën milingona; imagjinoni përpjekjet që bën ajo për të hipur në ndonjë mur. Mundet që ky mur të jetë i lëmuar, kështu që ajo ngjitet e bie, përpiqet andej e këndeje, e ndodh që një gjë e tillë të përsëritet më shumë se dhjetë herë.

Ndodh që ndonjëri prej nesh ndërmerr ndonjë projekt, apo ndonjë punë, një herë, dy apo tri herë, më pas zmbrapset. Më i miri ndër ne është ai që arrin objektivin e

“Një milingonë e pickoi një profet dhe ai e dogji të gjithë folenë e tyre, ndërsa Allahu i shpalli. A e dogje një popull që lartësonte dhe i bënte tesbih Allahut, a nuk të mjaftoi të digjje vetëm atë që të pickoi” ... ”

tij në përpjekjen e tretë, ndërsa milingona, nuk resht së përpjekuri.

E shikon lexues i nderuar! Nëse dobësohesh, kujto milingonën dhe përpjekjet e saj. Kujto milingonën dhe seriozitetin që ajo ka në punë! A nuk e keni parë milingonën kur mban farat? Ajo mban mbi vete shumë herë më tepër se pesha e saj dhe përshkruan me të distanca të mëdha dhe në vende të vështira. Vërtet ne kemi shumë nevojë për një seriozitet dhe këmbëngulje të tillë, sidomos në çështjen e kërimit të dijes. Ka prej dijetarëve muslimanë, të cilët janë ende gjallë që e fillojnë kërkimin e dijes që mbas namazit të sabahut e deri në namazin e jaciesë pa ndërprerje, ndërsa ne lodhemi kur dëgjojmë një mësim apo ligjëratë nga akshami e deri në jaci.

Nga cilësitë e milingonës është besnikëria.

Në bashkësinë e milingonës gënjeshtria nuk ka vend, si mendoni ju për një gjë të tillë? Në mesin e tyre nuk njihet gënjeshtër e pastër apo e papastër. **Imam Ibën Kajim el-Xheuzije tregon një histori, e cila e vërteton një gjë të tillë:** Një burrë

duke ndenjur vendos një thërrime ëmbëlsire në tokë, e gjen atë një milingonë dhe i dërgon sinjal shoqeve të saj, kur vinë ato afër vendit ky burrë e ngre këtë thërrmijë ëmbëlsire, ato kërkojnë andej këndeje, e pasi nuk e gjejnë largohen. Kjo ndodhi tre herë, herën e tretë ato e venë këtë milingonë në mes dhe e shqyejnë copa-copa me akuzën si gënjeshtare.

Si mendoni nëse këtë e aplikojmë me veten tonë? Vallë, a i kalon ndonjërit prej nesh java e ai të mos gënjejë? Nëse je vërtet i tillë atëherë e meriton që të përgëzohesh, por ne e kemi liruar perin në këtë pikë dhe jemi shumë të shkujdesur ndaj saj, ndërsa bashkësia e milingonës nuk e njeh gënjeshtren.

Nga cilësitë e milingonës është bashkëpunimi, ato nuk janë egoiste.

Nëse shikon një grumbull milingonash, a sheh se ato ecin gjithsecila në qejf të vet? Është e pamundur. Ato ecin në një vijë edhe nëse rruga nuk është e përshtatshme. Po ashtu është pohuar nga zoologët se nëse një milingonë sëmuret, atëherë milingonat e tjera nuk e lënë atë, porse ato bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për ta transportuar në fole që më pas ta kurojnë.

Bashkëpunimi i milingonave është i habitshëm, kur ato gjenden përpara një vije me ujë; a e dini sesi ia bëjnë për ta kaluar atë? Vjen një grup milingonash, hyjnë në ujë dhe me shpejtësi e çajnë atë dhe ndërtojnë një urë mbi të cilën kalojnë milingonat e tjera. Edhe pse shumë prej milingonave, të cilat hyjnë në ujë mbyten, përsëri ato sakrifikojnë për të shpëtuar milingonat e tjera. A nuk është kjo me të vërtetë e habitshme? A nuk e shikoni se sa shumë kemi nevojë ne për shembuj të tillë

sakrifice, të cilat sot po na i mëson milingona?!

Shoqëria e milingonave nuk njih rrëmuje.

Kjo krijesë kaq e vogël, që ne nuk na e mbush mendjen, ka një rregull dhe sistem drejtues të habitshëm në vetveten e saj. Tek ato nuk ka rrëmuje. Çdonjëra prej tyre e di funksionin dhe detyrën e saj. Foleja e milingonave ka mbretëreshën që merret me vezët dhe mbretërinë, ushtarët që ruajnë folenë nga armiqtë, punëtorët që hapin tunele dhe transportojnë ushqimin, grupi i zbulimit që merret me gjetjen e ushqimit dhe informacionin e tij. Është me të vërtetë një shoqëri shembullore me një rregull preciz. Të gjithë atje punojnë të barabartë, nuk gjen të privilegjuar e as milingona që mbahen me hatër. Po ne në punët që bëjmë a mbajmë me hatër dhe a kemi të privilegjuar?!

Milingonat janë bashkësi e pastër.

Shkencëtarët kanë vërtetuar se disa milingona në disa raste e pastrojnë veten më tepër se njëzet herë në ditë. Ndërsa ne themi: Ai që e pastron veten çdo të xhuma Allahu e shpërbleftë, sepse ka njerëz që rrinë dy apo tre javë pa u larë, mund të hyjë në xhami e njerëzit nuk munden t'i rrinë dot afër. Ndaj nëse bëhesh dembel dhe përton të pastrohesh, menjëherë kujto milingonën.

Milingona është bashkësi që e lartëson dhe i bën tesbih Allahut.

Një gjë e tillë është pohuar në hadithin që e përcjell Ebu Hurejre, se Profeti salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Një milingonë e pickoi një profet dhe ai e dogji

të gjithë folenë e tyre, ndërsa Allahu i shpalli. A e dogje një popull që lartësonte dhe i bënte tesbih Allahut, a nuk të mjaftoi të digje vetëm atë që të pickoi”. Buhariu dhe Muslimi.

Çdo gjë e lartëson Allahun ndërsa krijesat që e lartësojnë më pak Atë, jemi ne njerëzit, janë dhe xhindet.

Le të shohim në vetet tona: Sa e përmendim ne Allahun? Më i miri ndër ne është ai që e plotëson tesbihun mbas çdo namazi.

Por në përfundim po e mbyll me një lloj tjetër të milingonave, një lloj që ndryshon nga ai që kemi folur deri tani. Ajo është milingona e bardhë. Ky insekt përfaqëson një pjesë të mirë të shoqërisë sonë në të cilën ne jetojmë. Shembulli i saj është si shembulli i munafikëve, të cilët shfaqin besimin dhe fshehin mohimin. Dhe milingona për të cilën ne po flasim, punon gjithmonë në fshehtësi. Milingona e bardhë gërmon thellë në tokë, ajo mund ta ndërtojë folenë e saj në një thellësi prej 45 m, ndërsa milingona për të cilën folëm lart hyn në tokë vetëm disa centimetra. Shikoni sa dallim kanë ato nga njëra-tjetra.

Shoqëria Islame është shoqëri e pastër, e shëndoshë dhe e drejtë, ajo vepron gjithmonë punë të qarta, nuk ka të fshehta, ndërsa milingona e bardhë shihni sa thellë hyn, sepse kështu ajo mund t'i realizojë planet dhe qëllimet. Kështu janë dhe hipokritët, Allahu tregon për munafikët kur thotë: “*Kur i shihni ata, pamja e tyre e bukur ju mahnit, e nëse flasin, ju i dëgjoni fjalët e tyre. E megjithatë ata janë si trungje të rrëzuara*”. Munafikunë, 3. ■

Zgjedhi e përktheu: Bledar Haxhiu

INVESTIMET PËR BOTËN E ARDHSHME

Po qe se tregohemi aktivë në punë të mira, pa dyshim se ato do të jenë kursimet tona në Ditën e Gjykimit; pra, veprat në këtë botë do të jenë pasaporta për të hyrë në xhenetet e Allahut

SHKRUAN: MR. FEHIM DRAGUSHA

Falënderimet më të singerta dhe lavdërimet i takojnë vetëm Krijuesit, Sunduesit të kësaj gjithësie. Atë e falënderojmë që na dalloi nga të gjitha krijesat e tjera duke na dhuruar mendjen, arsyen, intelektin e mbi të gjitha na krijoi në formën më të përsosur. Paqja e shpëtimi i Tij qofshin për vulën e pejgamberëve, Muhamedin alejhi salatu ue salam, për familjen e tij të ndershme, për shokët e tij të dashur dhe për mbarë bamirësit besimtarë.

Lexues të nderuar, duke vepruar punë të mira, në çdo vend dhe në çdo kohë do të jemi në gjendje ta ngremë besimin tonë. Të përkujtojmë, se kjo botë ka edhe fundin e vet, prandaj askush nuk do të jetojë në të përgjithmonë. Ne jemi kalimtarë të rastit dhe duhet të punojmë që të përgatitemi për destinacionin tonë të fundit, që është bota e amshueshme. Një ditë do të kthehemi te Krijuesi dhe këtë botë do ta braktisim njëherë e përgjithmonë. Pas do të lëmë familjet, shokët, pasurinë si dhe çdo gjë tjetër që kemi fituar gjatë qëndrimit tonë në këtë botë. Allahu i Plotfuqishëm u drejtohet krijesave të Tij duke iu thënë:

“O populli im, kjo jetë e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se një përjetim i

përkohshëm, ndërsa bota tjetër është ajo e përhershme.”

Përse të mos e shfrytëzojmë këtë botë si përgatitje për botën tjetër, botë e cila është e përjetshme dhe në të cilën nuk ka më vdekje? Të tregojmë kujdes, pasi për çdo gjë që veprojmë në këtë botë do të ketë shpërblim apo ndëshkim për të, varësisht nga punët që kemi bërë. Në lidhje me këtë Allahu i Madhërishëm thotë:

“Kush bën ndonjë vepër të keqe, ndëshkohet vetëm për atë që është ajo, e kush bën ndonjë vepër të mirë, qoftë mashkull a femër, por duke qenë besimtar, të tillët hyjnë në xhenet dhe aty shpërblehen pa masë.”

Prej nesh kërkohet që të jemi sa më të kujdesshëm kur është fjala për shfrytëzimin e jetës në këtë botë; të veprojmë sa më shumë vepra të mira që është e mundur. Po qe se tregohemi aktivë në punë të mira, pa dyshim se ato do të jenë kursimet tona në Ditën e Gjykimit; pra, veprat në këtë botë do të jenë pasaporta për të hyrë në xhenetet e Allahut, të cilat janë të stërmbushura me shumë madhësi dhe bukuri të ndryshme, të cilat as që mund t'i imagjinojmë. Për të arritur sukses në shtimin e kursimeve për botën e ardhshme ekzistojnë vetëm dy mënyra:

E para, duke kryer detyrimet e Allahut

me plot sinqeritet, si për shembull falja e pesë kohëve të namazit dhe xhumaja, dhënia e zekatit, agjërimi i ramazanit, shkuarja në haxhillëk etj. Shpërblimi për veprat në fjalë do të regjistrohet në çastin e kryerjes së ibadetit.

Mënyra e dytë dallon krejtësisht nga e para për shkak se besimtari apo besimtarja në këtë rast nuk do të shpërblehet vetëm atëherë kur e kryen punën e mirë, mirëpo shpërblimi për veprën që ka bërë do të vazhdojë edhe më tutje, deri në Ditën e Gjykimit. Këto lloj veprash të mira llogariten si kursime për ahiretin (botën e amshueshme). Prandaj edhe themi se nga lëmoshat më të mira llogaritet sadakaja e vazhdueshme. Lëmoshë e vazhdueshme do të thotë nëse njerëzit në vazhdimësi përfitojnë nga projekte të ndryshme, fjala vjen ndërtimi i ndonjë xhamie, apo i ndonjë spitali, furnizimi me ushqim apo ujë të pijshëm, mbështetja mujore e një apo më shumë jetimëve gjithashtu hyn nën këtë ombrellë. Prandaj ne duhet të jemi bujarë, t'u japim sadaka atyre që janë në krizë, të kontribuojmë për ndërtimin e xhamive, rrugëve, spitaleve, shkollave, jetimoreve etj. Atyre që me të vërtetë ndihmojnë në këtë drejtim, pa dyshim se shpërblimi do t'u shkojë edhe në varr, qoftë edhe nëse kanë mbjellë vetëm një pemë në këtë botë dhe prej asaj peme hanë të tjerët.

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Nëse njeriu vdes, ndalen veprimet e tij, përveç tre gjërave: një lëmoshë e vazhdueshme, një dije e dobishme dhe fëmija i mirë, që lutet për të.”*

Këto janë tri veprat, shpërblimet e të cilave i shkojnë besimtarit edhe pas vdekjes së tij. Po ashtu nga ne kërkohet që diturinë e fituar ta shfrytëzojmë për të mirë, duke i mësuar të tjerët; duke e përhapur atë, apo duke e ndihmuar njerëzimin me dituri të dobishme. Çështja e tretë që është



përmendur në hadithin e sipërshtuar na bën me dije vlerën që ka edukimi i fëmijëve, si dhe devotshmëria e tyre, të cilët do të luten për ne edhe atëherë kur ne do të kemi ndërruar jetë.

Për t'u begatuar me fëmijë të mirë dhe të devotshëm kërkohet punë dhe mund. Fëmijët nuk mund të edukohen brenda një nate, siç mendojnë një grup njerëzish, mirëpo duhen sakrifikuar vite të gjata, në mënyrë që fëmijët të arrijnë deri në atë shkallë devotshmërie. Lëmosha (sadakaja) renditet ndër investimet më të lehta që

mund të realizohet. Çdo person zotëron lloje të ndryshme pasurie, përmes së cilës mund të ndihmojë nevojtarët. Ndihma apo kontributi nuk mund të bazohet vetëm në të holla. Nuk është fare me rëndësi se sa është shuma që kemi dhuruar apo lloji i pasurisë, me rëndësi është që besimtari apo besimtarja kur të japë diçka nga pasuria e vet, atë ta japë me sinqeritet.

Allahu subhanehu ue teala, thotë: ***“E shembulli i atyre që pasurinë e vet e japin nga bindja e tyre e duke kërkuar kënaqësinë e Allahut, i përngjan një kopshti në një rrafshnaltë që i bie shi i madh, e ai jep fruta të dyfishtë. Po edhe nëse nuk i bie shi i madh, i bie një rigë (që i mjafton). Allahu sheh atë që vepron.”***

Ky ajet na tregon shumë mirë, se Allahu subhanehu ue teala, e pranon ndihmën dhe lëmoshën që realizohet me sinqeritet për të arritur kënaqësinë e Tij, të Allahut Fuqiptotë. Gjithashtu hapja e kësaj rruge, gjegjësisht dhënia e sadakasë (lëmoshës) bën që besimtari të fitojë shpërblim të dyfishtë, edhe në qoftë se lëmosha është një shumë fare e vogël.

Sadakaja e vazhdueshme nuk përkufizohet vetëm në para, pa marrë parasysh çfarë zotërojmë, por nëse me të vërtetë e kemi dhënë me sinqeritet, pa dyshim se për këtë do ta gjejmë shpërblimin tek Allahu i Madhëruar. Feja Islame na mëson që neve si umet që jemi, ta ndihmojmë njerëzimin në përgjithësi.

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, thotë: ***“Më i miri prej njerëzve është ai që u sjell dobi të tjerëve.”***

“Allahu do të jetë gjithmonë në ndihmën e robit të Tij përderisa rob i Tij është në ndihmë të vëllait të vet.”

Sadakaja apo dhënia lëmoshë fillimisht pastron pasurinë, siç thotë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem: ***“O ju të pasur, me të vërtetë në këtë shitblerje janë***

“Allahu do të jetë gjithmonë në ndihmën e robit të Tij përderisa rob i Tij është në ndihmë të vëllait të vet.”...”

të pranishëm përбетuesi dhe rrenacaku, pra, pastrojeni atë me lëmoshë”.

Sadakaja gjithashtu e pastron trupin e njeriut nga mëkatet, siç thotë Allahu subhane ue teala: ***“Merr prej pasurisë se tyre lëmoshë që t’i pastrosh me të dhe t’u shtosh (të mirat)...”***

Në fund mund të themi, se sadakaja largon fatkeqësitë dhe sëmundjet nga rob i Allahut. I Dërguari i Allahut në një hadith të tij na thotë: ***“Shëroni të sëmuret me lëmoshë”.***

Po ashtu ajo fut hare dhe kënaqësi në gjoksin e të varfrit. Na përcillet nga Muhamedi salallahu alejhi ue selem, se ka thënë: ***“Vepra me e dashur tek Allahu është të fusësh kënaqësi në gjoksin e besimtarit”.***

Të gjitha këto që përmendëm janë dobitë dhe të mirat që sjell lëmosha në dynja, ndërsa për sa u përket dobive që sjell në botën e amshueshme mund të veçojmë: lëmosha do të jetë mburojë nga nxehtësia e madhe e asaj dite për atë që ka dhënë sadaka; besimtarit ia lehtëson llogarinë Ditën e Gjykimit; peshoren ia rëndon me vepra të mira; gjithashtu e ndihmon që ta kalojë Urën e Siratit me lehtësi, si dhe besimtarin apo besimtaren e ngre në shkallët më të larta të xhenetit.

Lusim Allahun Fuqiptotë që të na e marrë shpirtin si muslimanë dhe të na bëjë të mundur, që të investojmë sa më shumë për botën e amshueshme, për ditën kur nuk do të na bëjnë dobi, as fëmijët, as pasuria. ■

SHPËTIMI NGA PASURIA HARAM, SIÇ ËSHTË KAMATA

Pra, ai që dëshiron të shpëtojë nga pasuria haram dhe të bëjë teube, ndërsa nuk ka mundësi që të njëjtën pasuri t'ua kthejë pronarëve, atëherë në emër të atyre pronarëve le t'i shpenzojë në rrugë të Allahut

(vazhdon nga numri i kaluar)



HALID EL MUHENNA

Dega e dytë: Ku mund të harxhohen të hollat e kamatës

Rreth asaj se ku lejohet të harxhohen këto lloj pasurish fukahatë kanë disa mendime.

Mendimi i parë: Në dobitë e përgjithshme të muslimanëve.

Kur themi dobitë e muslimanëve kemi si qëllim ato gjëra prej të cilave përfitojnë muslimanët në përgjithësi dhe jo ndonjë individ, sikurse ndërtimi i hekurudhave, digave, rrugëve etj.

Ky është mendimi i Shejhul Islam Ibën Tejmijes.¹

Mendimi i dytë: Në çdo gjë ku jepet edhe sadakaja vullnetare në përgjithësi.

Kjo është më përfshirëse sesa fjala “dobitë e muslimanëve”, sepse këtu përfshihen dobitë, ndërtimi i xhamive dhe ndihma e fukarenjve, sepse në të gjitha këto derdhet sadakaja. Ky është mendimi i hanefive², malikive³, i imam Ahmedit⁴, i hanbelive⁵ dhe i Gazaliut prej shafive⁶.

Mendimi i tretë: Në dobitë e muslimanëve dhe në ndihmë të fukarenjve, por jo edhe për xhami.

¹ Mexhmuul Fetava (29/264), Bedaiu Sanaië (7/154-155)

² Hashijetu Ibën Abidin (3/223)

³ Elxhamië li ahkamil Kur'an, Kurtubi (3/266)

⁴ El Furuë, Ibën Muflih (4/513)

⁵ Mexhmuul Fetava (29/264), El Fetava elKubra (4/210-213), El Furuë (2/667)

⁶ El Mexhmuë (9/428)

Ky është mendimi i Komisionit të përhershëm për Fetva në Arabinë Saudite⁷ dhe mendimi i Këshilltarit Fetar për Shtëpinë e Financave në Kuvajt.⁸

Mendimi i katërt: Lejohet t'i harxhojë në rrugë të Allahut.

Qëllimi është: në ndihmë të xhiadit, i cili bëhet për hir të Allahut, subhanehu ue teala.

Ky është mendimi i Shejhul Islam Ibën Tejmijes, i cili ka thënë: “Madje edhe ai, që me dorën e tij ka fituar një pasuri haram dhe nuk ka mundësi t’ia kthejë pronarëve, sepse nuk i njeh, apo për ndonjë shkak tjetër; ose ka në mbikëqyrje depozitime, pengje apo të ngjashme dhe më pas i pamundësohet t’i gjejë pronarët, atëherë le t’i shpenzojë në rrugë të Allahut, sepse kështu lejohet të harxhohen. Ai që ka shumë gjynahe, ilaçi më i mirë është xhiadi, sepse ashtu Allahu ia falë gjynahet, siç na ka treguar në Librin e Tij: “*...ua falë juve gjynahet...*”. Pra, ai që dëshiron të shpëtojë nga pasuria haram dhe të bëjë teube, ndërsa nuk ka mundësi që të njëjtën pasuri t’ua kthejë pronarëve, atëherë në emër të atyre pronarëve le t’i shpenzojë në rrugë të Allahut. Kjo është një metodë e mirë për të shpëtuar nga harami dhe kështu arrihet një sevap i madh nga xhiadi...”.

Argumentet e katër mendimeve:

Argumentet e mendimit të parë dhe të dytë:

Argumentet e katër mendimeve janë shumë të përafërta. Dallimi është aty se këta të mendimit të parë, nga sadakaja në përgjithësi e kanë përcaktuar që dobia të jetë e përgjithshme, por – sipas asaj me sa kam lexuar – unë nuk kam hasur në ndonjë argument për këtë përcaktim.

Ndërsa, argumentet e veçanta të

mendimit të dytë janë:

Ata thonë: Çdo pasuri që nuk ka pronar mund të shpenzohet aty ku shpenzohet sadakaja¹⁰. Në këtë aludon ngjarja me kaullin, që Ebu Bekri, radijallahu anhu, e bëri para hixhretit me rastin e zbritjes së ajetit: “*Elif, lam, mim, u mundën bizantinët, në afërsi të tokës* (arabe), *por pas thyerjes së tyre, me siguri do të fitojnë...*” dhe atëherë jobesimtarët e Mekës thanë: “*A me të vërtetë mendoni se bizantinët do të fitojnë prapë?*”, Po – u përgjigj Ebu Bekri. *A lidhemi pra, në kaull* – thanë ata. Po – u përgjigj Ebu Bekri dhe pastaj shkoi e i tregoi Resulullahut, salallahu alejhi ue selem, se ka lidhur kaull me jobesimtarët, ndërsa ai i tha: “*Shko tek ata dhe rrite çmimin e kaullit*”. Ashtu edhe bëri. Ashtu ndodhi, bizantinët fituan mbi persianët, ndërsa Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur me të, mori fitimin nga kaulli dhe këtë ia lejoi i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, dhe në fund i tha: “*Shpërndaje si sadaka*”. (sahih)

Gjithashtu argument është ajo që përcjell Asim b. Kulejbi nga i ati, e ai nga njëri prej ensarëve, i cili rrëfen: “Dolëm së bashku me të Dërguarin, salallahu alejhi ue selem, në një xhenaze dhe e shihja Pejgamberin, salallahu alejhi ue selem, ndërsa qëndronte pranë varrit, i sugjeronte hapësit të varrit: “Zgjeroji nga ana e këmbëve, zgjeroji nga ana e kokës”, kur u kthye, dikush e ftoi në emër të një gruaje dhe ai pranoi. E sollën ushqimin dhe ai zgjati dorën për të marrë e po ashtu edhe shokët e tij, të cilët edhe hëngrën, ndërsa i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, mbeti duket përtypur kafshatën në gojë dhe tha: “*Mua më duket se kjo dele është marrë pa lejen e pronarëve të tij*”. Atëherë gruaja dërgoi arsyetimin e saj: O i Dërguar, unë

⁷ Mexhmuu Fetava Lexhneti Daime (13/354)

⁸ Fetvaja nr: 42

⁹ Mexhmuu Fetava (28/401)

¹⁰ Bedaiu Sanaï (7/154-155), ElFetava elKubra (4/210-213), El Furuë (4/513), El Insaf (6/212-213)

“...nuk lejohet t’u kthehet kjo pasuri, por duhet të shpenzohet duke e shpërndarë si sadaka, duke treguar kujdes ndaj fukarenjve, sepse kamata është shkaku i fukarallëkut...”

porosita që të më blihet një dele nga tregu i Bekias, por nuk kishte, atëherë çova fjalë te komshiu, i cili kishte blerë një dele, të ma shesë atë me të njëjtin çmim, por ai nuk u pajtua, atëherë i çova fjalë shoqes së tij, e ajo ma dha delen. Në këtë rast, i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, tha: *Le të hanë robërit nga ky ushqim*”. (Sahih Ebu Davud nr. 3332)

Po ashtu ka edhe fjalë nga gjeneratat e para (selef), se këto lloj pasurish duhet të shpenzohen në sadaka:

Malik b. Dinari tregon se një njeri e kishte pyetur Atain: Kur isha më i ri kam fituar pasuri me metoda që nuk i pëlqej më dhe tani dua të pendohem. - Ktheja pronarëve të vet – e porositi Atai. Nuk i njoh – u përgjigj njeriu. Atëherë jepi sadaka. Ty nuk të takon sevap për atë sadaka, ndërsa nuk e di, a je liruar nga mëkati ose jo – e këshilloi Atai. Malik b. Dinari shton: Për këtë gjë kam pyetur edhe Muxhahidin dhe të njëjtën përgjigje më ka thënë¹¹.

Argumentet e mendimit të tretë:

Edhe këta janë argumentuar me argumentet e mendimit paraprak, ndërsa kanë përfunduar ndërtimin e xhamive, sepse ato duhet ndërtuar vetëm me pasuri të pastër.

Argumentet e mendimit të katërt:

Xhihadi është shkaku për faljen e

gjynaheve, gjë për të cilën ka nevojë ai që punon me kamatë. Gjithashtu ta ndihmosh xhihadin llogaritet xhihad.

Shqyrtimi i argumenteve:

Kur meditojmë rreth mendimit të parë dhe të dytë, vërejmë se ato janë një, sepse prej dobive të përgjithshme të muslimanëve është dhe kujdesi e ndihma për fukarenjtë. Sidomos, nëse prej shkaqeve të fukarallëkut është kamata, atëherë mund të themi se ato para janë të tyre.

Sa i përket mendimit të katërt: Kur meditojmë mbi fjalën e Ibën Tejmies, nuk vërejmë se e kufizon harxhimin vetëm për xhihad, por ai tregon se ajo është më e mira. Madje, edhe sadakaja është prej shkaqeve që i shlyen gjynahet.

Na mbetet mendimi i tretë: Ky mendim ka një epërsi, sidomos kur nuk jemi të sigurt se shpenzuesi i kësaj pasurie ka dhënë tërë mundin që t’i gjejë pronarët e asaj pasurie. Shtoja kësaj edhe çështjen e dyshimit, e pastaj edhe degëzimin e kësaj në meselenë: A është i saktë namazi në një vend të vjedhur? Pra, për adhurimin në përgjithësi, e sidomos për namazin duhet të jemi sa më larg gjërave të dyshimta.

Dega e tretë: Kush duhet të marri përsipër ndarjen e të hollave të kamatës

Fukahatë, në këtë çështje kanë përmendur dy mendime:

Mendimi i parë: Udhëheqësi i vendit, sepse ai ka më shumë njohuri për dobitë e përgjithshme dhe ka mundësi ta kryejë më së miri këtë.

Mendimi i dytë: Ai që i ka në dorë ato të holla. Ky është mendimi i Imam Ahmedit dhe një gjë e tillë kuptohet edhe nga fjalët e Shejhul Islam Ibën Tejmies¹².

Këtë e kanë kuptuar nga fakti se kësisoj kanë folur dhe vepruar gjeneratat e para,

¹¹ Musannef, Ibën Ebi Shejbe 5/380-381

¹² Mexhmuu Fetava (28/401), (29/264)

sikurse na përcjell Ibën Ebi Shejbe në “Musannef” nga Malik b. Dinari, se dikush e kishte pyetur Ata b. Ebi Rebahun: Një njeri, ka fituar pasuri haram. “Le t’ia kthejë pronarëve të vet, e nëse nuk i njeh, atëherë le t’i japë sadaka. Por, nuk e di, a është liruar nga mëkati” – u përgjigj ai.

Argument për këta mund të jetë edhe krahasimi me zekatin, sepse zekatdhënësi ka të drejtë që personalisht vetë t’u shpërndajë fukarenjve.

Ajo që duket, – Allahu e di më së miri – nëse themi se ajo pasuri duhet harxhuar në dobi të përgjithshme, atëherë këtë mund ta kryejë më mirë udhëheqësi i vendit. Por, nëse themi se ajo duhet të jepet sadaka, duke i përfshirë këtu edhe fukarenjtë, atëherë këtë më mirë mund ta kryejë vetë ai që i ka në dorë ato pasuri. E ndoshta i ndal edhe për vete, nëse është fukara, siç ka aluduar Ibën Tejmie.

Por, për sa i përket udhëheqësit të vendit, ne duhet të kemi parasysh, se bëhet fjalë për një udhëheqës të drejtë, besnik dhe fetar.

Dega e katërt: Nëse dihet se kamatëdhënësi merret vazhdimisht me kamatë dhe po qe se ia kthejmë të hollat nga kamata, kjo nuk do të ndryshojë asgjë, si ia bëjmë në atë rast?

Në librin “el-Mexhmu”¹³ të Neveviut kemi: “Gazaliu ka thënë: Nëse të bie në dorë një pasuri haram, e cila është pronë e udhëheqësit, disa kanë thënë: Duhet t’ia kthejë udhëheqësit e jo ta japi sadaka, sepse ai e di më së miri se ç’duhet të bëjë me pasurinë e tij. Harith el-Muhasibi ka zgjedhur këtë mendim.

Ndërsa të tjerë kanë thënë: Duhet ta japi sadaka, nëse e di se udhëheqësi nuk ia kthen atë pasuri pronarit të vërtetë, sepse po t’ia kthente atij vetëm do të shtonte padrejtësinë.

Mendimi i vërtetë është: Nëse e di se udhëheqësi nuk ia kthen prapë këtë pasuri pronarit që i takon, atëherë duhet që kjo

pasuri të jepet sadaka në emër të pronarit të vërtetë. Pra, nëse e di se udhëheqësi do ta shpenzojë këtë pasuri në gjëra të kota, apo kështu na thotë supozimi i qartë, atëherë duhet të shpenzohet në gjërat e dobishme për muslimanët, sikurse hekurudhat dhe të ngjashmet. Nëse s’ka mundësi ta bëjë këtë gjë, për shkak të ndonjë frike apo diçkaje tjetër, atëherë duhet t’i jepet sadaka atij që ka më shumë nevojë. Më të nevojshmit për këtë janë ushtritë muslimane. Por, nëse mendon se udhëheqësi nuk do ta shpenzojë atë pasuri në gjëra të kota, atëherë duhet t’ia kthejë atij ose zëvendësit të tij. Sepse udhëheqësi i njeh më mirë nevojat e përgjithshme dhe ka më shumë mundësi ta bëjë atë, e nëse ka frikë se po t’ia kthejë atij do të ndodhë ndonjë dëmtim, atëherë ky vetë duhet ta shpenzojë aty ku thamë se mundet ta shpenzojë, në raste kur frikësohet se udhëheqësi do ta shpenzojë në gjëra të kota”.

Nëse ndalemi për t’i shikuar dhe medituar rregullat e përgjithshme të Sheriatit, mund të themi: Kthimi i të hollave të kamatës, sidomos në gjendjen aktuale të bankave, të cilat e promovojnë publikisht kamatën dhe do t’i shfrytëzojnë këto të holla për të shtuar buxhetin e tyre së paku, atëherë themi se nuk lejohet t’u kthehet kjo pasuri, por duhet të shpenzohet duke e shpërndarë si sadaka, duke treguar kujdes ndaj fukarenjve, sepse kamata është shkak i fukarallëkut. Allahu e di më së miri.

Ky është hulumtimi, që m’u mundësua rreth kësaj çështje. E lus Allahun që mua dhe të gjithë muslimanët t’i shpëtojë nga kamata, nga haramet dhe mëkatet shkatërruese. Vërtet Ai dëgjon dhe përgjigjet dhe Ai e di më së miri.

Paqja, lavdërimi dhe shpëtimi qofshin mbi pejgamberin tonë, Muhamedin, mbi familjen e tij dhe shokët e tij. Amin! ■

Përktheu: Omer B.

¹³ (9/429)

ANGAZHIMI

Shumica e kompanive falimentojnë, shumë lidhje bashkëshortore dështojnë për të vetmin shkak, atë të mungesës së angazhimit.

SHKRUAN: AGRON TERZIQI

Njerëzit në shumicën e rasteve dështojnë jo për shkak të mungesës së aftësive dhe kapaciteteve të tyre, por për shkak të mungesës së angazhimit. Ndërsa meditojmë për njerëzit e suksesshëm, ne mund të vërejmë se besimi i fuqishëm, pasioni i fortë dhe angazhimi i tyre ka qenë më i madh, se sa sfidat dhe pengesat që të tjerët ua kanë vënë.

Ndodh që të kesh shkallë të lartë të

entuziazmit, aftësi të mëdha, njohuri të gjera, synime të qarta dhe konkrete për të cilat ëndërron ditë e natë që t'i realizosh, duke shpresuar gjëra pozitive nga ato, mirëpo nëse të mungon angazhimi për t'u ballafaquar me mangësitë dhe pengesat në rrugën e realizimit të këtyre synimeve, gjithsesi do të dështosh. Shumica e kompanive falimentojnë, shumë lidhje bashkëshortore dështojnë për të vetmin shkak, atë të mungesës së angazhimit.

Një mendimtar thotë: "Këmbëngul gjithmonë, sepse në këtë botë nuk ekziston



asgjë që mund t'i zërë vendin asaj. Vetëm talenti nuk mjafton, ka shumë njerëz të talentuar që janë dështakë, ndërsa zgjuarsia vetvetiu nuk është garanci për sukses. Shumë njerëz të zgjuar nuk kanë përfituar asgjë nga zgjuarsia e tyre. Nuk është i mjaftueshëm vetëm shkollimi, pasi bota është e mbushur plot me njerëz të shkolluar të cilët janë joproduktivë. Ato që garantojnë suksesin janë këmbëngulja dhe vendosmëria, me lejen e Zotit.” Prandaj orvatu dhe lufto deri në frymën tënde të fundit.

Angazhimi është forcë, e cila na shtyn të vazhdojmë edhe përkundër kushteve të vështira, ajo është fuqi shtytëse që na udhëheq në realizimin e veprave të mëdha. Angazhimi i ndryshon gjërat e zakonshme, duke i transformuar në gjëra madhështore. Ajo është diçka, që të bën të përshtatshëm largësi të gjata edhe nën rrebeshin e madh të shiut. Angazhimi nxjerr nga brendia jote të gjitha kapacitetet dhe aftësitë e mundshme dhe i vë në dispozicionin tënd. Me forcën e angazhimit nuk do të ngecësh, si dhe sa herë që ballafaqohesh me ndonjë përvojë të re, mundësitë do të hapen shumë e më shumë përderisa të korrësh suksesin.

Një herë një dijetar qe pyetur se kur konsiderohet dikush i dështuar? Ai u përgjigj: “Kur dikush ka një ëndërr të madhe, ka nxënë dije të mëdha, ka shpenzuar shumë pasuri dhe kohë që të përparojë në aftësitë e tij, që të gjitha këto për ta realizuar ëndrrën e tij, mirëpo në çastin e përballjes me sprova dhe pengesa gjatë realizimit të ëndrrës së tij ka hequr dorë nga angazhimi dhe përpjekjet”.

Ekziston një fjalë e vjetër e urtë: **Të suksesshmit nuk zmbarsen, ndërsa të zmbarsurit nuk korrrin sukses.** Me lejen e Zotit nuk do të dështosh ndonjëherë, por vetëm atëherë kur do të ndalosh nga angazhimi dhe orvatja. Çelësi i suksesit i

“...Detyrojeni veten që t'i realizoni ëndrrat tuaja, duke sakrifikuar çdo gjë që zotëroni, pa marrë parasysh se çfarë thonë ata që ju rrethojnë...”

thënë shkurtimisht është “**mos u dëshpëro**”.

Më lejoni të bëj një pyetje. Sa herë keni pasur ëndrra dhe i keni braktisur ato për shkak të rrethanave dhe faktorëve të ndryshëm? A nuk ka ardhur koha që t'i nxirrni forcat tuaja të ngujuara në brendësinë tuaj? A nuk ka ardhur koha t'i jetësoni ëndrrat tuaja?

Detyrojeni veten që t'i realizoni ëndrrat tuaja, duke sakrifikuar çdo gjë që zotëroni, pa marrë parasysh se çfarë thonë ata që ju rrethojnë. Drejtojeni kapacitet tuaj nga realizimi i synimeve tuaja. Në rrugën tuaj drejt suksesit do të hasni në shumë sfida dhe mos i injoroni ato, por përballuni me të gjitha duke i mposhtur ato një nga një. Vazhdoni dhe kini parasysh gjithmonë se insistimi dhe këmbëngulja i largojnë të gjitha pengesat.

Këto janë disa këshilla se si të arrini shkallën e duhur të angazhimit:

- a) detyrojeni veten të jeni besimtarë të devotshëm;
- b) angazhohuni të jeni personat më të mirë brenda familjeve tuaja;
- c) detyrohuni që t'i realizoni synimet tuaja;
- d) vëri kusht vetes të jeni më të mirë në punët që bëni; dhe
- e) përpikuni të jeni bashkëshorti, prindi dhe shoku më i mirë në vendin tuaj. ■

MIRËSJELJA E BESIMTARËVE ME GRATË E TYRE

Pra, burrat këshillohen që të kalojnë jetë të mirë me gratë e tyre, me plot mirëkuptim dhe durim, sepse femrat në natyrën e tyre janë krijesa të dobëta, të ndjeshme, çka do të thotë se kanë nevojë për butësi, mirëkuptim dhe mbrojtje

SHKRUAN: ZEKI ÇERKEZI

Vetëm Allahun e falënderojmë dhe e lavdërojmë, paqja dhe shpëtimi qoftë mbi atë njeri pas të cilit nuk ka më pejgamber.

Allahu i Lartmadhëruar kur i krijoi njerëzit u ka dhënë atyre shumë dhunti, bile të panumërta. Allahu në Kuran thotë: *“Dhe Ai ju dha gjithçka që ju kërkuat dhe po të numëroni Dhuntitë (të Mirat) e Allahut, ju kurrë nuk do të ishit në gjendje t’i numëroni ato.”* (14: 34), si dhe në ajetin tjetër: *“Dhe sikur të mundohehit t’i numëroni Mirësitë e Allahut, kurrë nuk do të ishit në gjendje t’i radhitni ato.”* (16:18). Pra, shihet qartë, se Allahu i ka dhënë njeriut të gjithë atë që i nevojitet. Bile, një numër të konsiderueshëm të këtyre dhuntive (me përjashtim të dhuntisë më të madhe – Islamit) i gëzojnë edhe jobesimtarët! Merreni me mend se sa i Mëshirshëm është Allahu.

Por krahas shfrytëzimit të këtyre dhuntive, Allahu na ka ngarkuar edhe me disa detyrime. Qëllimi final i këtyre detyrimeve është arritja e harmonisë dhe e kënaqësisë shpirtërore e fizike. Në mënyrë të përgjithshme këto detyrime mund t’i ndajmë në tri kategori:

Kategoria e parë: Janë detyrimet e krijesës karshi Krijuesit. Me një rast i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, e pyeti Muadhin: *“O Muadh! Kush është haku i Allahut tek robërit e Vet dhe kush është haku i robërve tek Allahu?”* Muadhi u përgjigj: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri. I Dërguari salallahu alejhi ue selem, tha: *“Haku i Allahut tek robërit e Vet është që ta adhurojnë vetëm Atë, duke mos i bërë shirk asgjë.”*



Ndërsa haku i robërve tek Allahu është që kur ata nuk i bëjnë shirk, mos t'i dënojë, gjegjësisht t'i fusë në Xhenet". (Buhariu dhe Muslimi). Duhet të përmendet se haku i njerëzve, të cilët nuk bëjnë shirk, që mos të dënohen, kurrsesi nuk bën të kuptohet si detyrim i Allahut. Askush nuk mund ta detyrojë Allahun për asgjë. Por ky është premtimi i Allahut, që atij që nuk bën shirk, mos ta dënojë, e Allahu i plotëson premtimet e veta me përpikëri. Ndërsa njerëzit e kanë detyrim të prerë, që vetëm Allahun ta adhurojnë dhe njëkohësisht e kanë rreptësisht të ndaluar shirkun.

Kategoria e dytë: Janë detyrimet e njeriut ndaj vetvetes. Njeriu është i detyruar që të kujdeset për shëndetin e tij, për organet e tij. Nuk i lejohet që t'i shkatërrojë me substanca të dëmshme, sepse ato organe i ka amanet nga Allahu, për të cilat ai do të japë llogari. Allahu i Lartmadhëruar thotë: **"Me të vërtetë që të dëgjuarit, të shikuarit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi."** (17: 36).

Kategoria e tretë: Janë detyrimet ndaj të afërmit. Në këtë kategori përfshihen të gjitha krijesat (me të cilat kemi kontakt) në përgjithësi, e njerëzit në veçanti. Kuptohet, që sa më afër t'i kemi njerëzit, detyrimet janë më të mëdha.

Këto tri kategori detyrimesh, në një fare mënyre përmenden në hadithin e mirënjohur, ku i Dërguari salallahu alejhi ue selem, ka këshilluar veç e veç Ebu Dherin dhe Muadh b. Xhebelin, radijAllahu anhumu, duke iu thënë: **"Ki frikë Allahun kudo që të jesh (detyrimet karshi Allahut), pasoje mëkatin me një vepër të mirë për ta eliminuar mëkatin (detyrimet karshi vetvetes), dhe sillu me njerëzit me sjellje shembullore (detyrimet karshi njerëzve)".** (Tirmidhiu, Albani e vërteton këtë hadith)

Ne në këtë numër dhe inshaAllah në disa numra në vijim do të shtjellojmë tematika nga kategoria e tretë, përkatësisht do të

“...nëse burri mundohet të arrijë me vrazhdësi përmirësimin e atyre të metave, atëherë ajo familje do të shkojë buzë shkatërrimit...”

shkruajmë për detyrimet tona me njerëzit e tjerë, duke filluar prej më të afërmeve. Kur t'i shikojmë ajetet dhe hadithet, të cilat flasin për këtë tematikë, me të vërtetë do të shohim madhësinë e Islamit dhe më konkretisht do të kuptojmë domethënien e ajetit: **"Këtë ditë Unë e përsosa fenë tuaj për ju..."** (5: 3).

S'ka dyshim se faktor i rëndësishëm për harmoninë dhe mirëqenien familjare është raporti bashkëshortor, bile-bile ky raport është edhe katalizator i mirëqenies shoqërore, sepse kusht i patjetërsueshëm për harmoninë shoqërore është harmonia familjare.

Allahu, azze ue xhel, iu drejtohet burrave me këtë këshillë: **"Çoni jetë të mirë me to."** (4: 19). Pra, burrat këshillohen që të kalojnë jetë të mirë me gratë e tyre, me plot mirëkuptim dhe durim, sepse femrat në natyrën e tyre janë krijesa të dobëta, të ndjeshme, çka do të thotë se kanë nevojë për butësi, mirëkuptim dhe mbrojtje. Përndryshe çdo njeri në përgjithësi ka të meta, gabime, e femrat në veçanti. Për këtë shkak Allahu na mëson që ta kalojmë jetën duke bërë durim me to për disa veti të këqija, se ndodh që ato të kenë disa veti të tjera të mira dhe kështu do të kemi mirësi të mëdha. Allahu i Lartmadhëruar thotë: **"Nëse i urreni ato, bëni durim, pse ndodh që Allahu të japë shumë të mira në një send që ju e urreni."** (4: 19) . Ndërsa në një hadith të saktë, të cilin Muslimi e përcjell në Sahihun e vet, i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem,

ka thënë: “Mos ta urrejë besimtari besimtaren, e as mos ta armiqësojë, nëse ndodh që mos të pëlqejë një veti të saj, atëherë ka ndonjë veti tjetër, me të cilën do të jetë i kënaqur”. Nga ky ajet dhe nga ky hadith shihet qartë, se nuk bën që burri ta urrejë bashkëshorten, nëse nuk i pëlqen diçka nga edukata e saj, apo nga sjellja e saj, sepse njeriu duhet të jetë i drejtë dhe të punojë me drejtësi. Nëse dikush mendon se drejtësi është që sapo dikush të bëjë ndonjë gabim të dënohet, atëherë ai gabon shumë. Zaten besimtari duhet të udhëhiqet nga parimet e edukatës së lartë islame, si me bashkëshorten e tij, ashtu edhe me njerëzit e tjerë. Besimtari me virtyte të larta, kur dikush gabon ndaj tij ose e dëmton, duhet të mundohet që t’ia arsyetojë atë vepër. Mirëpo ne për fat të keq për veprat tona të shëmtuara mund të gjejmë shumë lehtë arsyetim, ndërsa për të tjerët nuk mundohemi fare të gjejmë rrethana lehtësuese, ose me shumë vështirësi i arsyetojmë. Ndërsa motoja e artë e besimtarit duhet të jetë: Gabimin tënd ndaj të tjerëve mos e harro – të mirën tënde harroje; gabimin e bërë ndaj teje harroje – të mirën që ta kanë bërë mos e harro. Kështu, kur është pyetur Llukmani i urtë, si e ka arritur atë shkallë të lartë edukate të mirë, ai është përgjigjur: Ju më keni mësuar! Ata të habitur e kanë pyetur: Si mund të thuash ashtu, kur ti dallohesh prej nesh me moral shembullor? Ai ka thënë: Nëse ndonjë sjellje e juaj ndaj meje nuk më ka pëlqyer, unë kam mësuar se nuk duhet të sillem ashtu me ju, dhe e kundërta, nëse më ka pëlqyer, unë atë sjellje e kam preferuar me ju.

Pra, drejtësi është që të peshohen veprat e mira dhe të këqija, dhe të shikohet se kush peshon më tepër, cilat vepra janë më vendimtare, më të rënda, më me ndikim, më dobiprurëse, dhe pastaj vendos çfarë qëndrimi të marrësh. Allahu në Kuran thotë:

“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë.” (5: 8), pra, mos t’ju shtyjë urrejtja nga drejtësia, bëhuni të drejtë. Nëse ajo bën ndonjë gabim, burri mos t’ia kthejë me të keq, të paktën jo në atë çast. Ai duhet të gjykojë drejtë e me gjakftohtësi, le t’i analizojë veprat dhe sjelljet e saj në të kaluarën, le ta mendojë edhe të ardhmen. Në këtë mënyrë inshaAllah, merr një vendim të drejtë. Aq më tepër kur dimë, se femrat janë krijesa të dobëta dhe kanë nevojë për mbështetje, përkrahje dhe mbrojtje, siç thotë edhe Allahu në Kuran: **“Burrat janë mbrojtësit dhe mbajtësit e grave, sepse Allahu e ka krijuar njërën palë prej tyre të shquhet mbi tjetrën dhe sepse ata shpenzojnë** (për t’i mbajtur ato) **nga mjetet e tyre të jetesës. Kështu, gratë e drejta janë të bindura me çiltërsi** (ndaj Allahut dhe ndaj burrave të tyre) **dhe ruajnë në mungesë të bashkëshortëve të tyre, çfarë Allahu i ka urdhëruar ato të ruajnë** (dëlirësinë, ndershmërinë e tyre, pasurinë e bashkëshortëve të tyre e të tjera).” (4: 34). Përndryshe, nëse burri kërkon realizimin e njëqind për qind të të drejtave të tij, kurrë s’do ta arrijë këtë, sepse të gjithë njerëzit janë krijesa me të meta, e në veçanti femrat, mangësitë e të cilave kurrë nuk mund të shmangen plotësisht. E nëse burri mundohet të arrijë me vrazhdësi përmirësimin e atyre të metave, atëherë ajo familje do të shkojë buzë shkatërrimit. Kështu na mëson ai që nuk flet nga mendja dhe epshi i tij salallahu alejhi ue selem, që me një rast ka thënë: **“Pranoni porosinë time që me gratë të silleni me dashamirësi, me mirësi. Vërtet gruaja është krijuar nga brinja dhe me të vërtet maja e brinjës është më e shtrembër. Nëse mundohesh ta drejtosh, do ta thyesh, nëse e lë ashtu siç është, do të mbetet e shtrembër. Pra, pranoni porosinë time për gratë”.**

(Buhariu dhe Muslimi)

Në një transmetim tjetër gjithashtu nga Buhariu dhe Muslimi, i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Femra është krijuar nga brinja, nëse dëshiron ta drejtosh, do ta thyesh. Nëse kënaqesh ashtu si është duhet të kënaqesh me shtrembërimin e saj”*. Pra, burri duhet të mundohet që të kënaqet me atë çfarë është ajo, duke bërë sabër. Për më tepër kur dihet se me këtë burrat fitojnë privilegie dhe ngrihen në grada të larta. Muhamedi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Besimtari me iman më të plotë është ai me moral më të mirë, ndërsa më i miri prej jush është ai që sillet më mirë me gruan e vet.”* (Tirmidhiu dhe Ebu Davudi). Me të vërtetë, që të vërtetën e ka thënë i Dërguari salallahu alejhi ue selem, sepse nuk është burrëri sjellja e keqe me gruan, por burrëri është kur burri është i sjellshëm me gruan e tij, i butë e i këndshëm. Vetëm kështu ndriçon shtëpia e çiftit në Islam, e përfshin harmonia dhe depërton Nuri Islam në atë shtëpi. Sepse *“kjo dunja është furnizim e pasuri, ndërsa pasuria më e madhe është gruaja e mirë dhe e devotshme (saliha)”*. (Muslimi). Si mos të jetë kështu, kur ajo kujdeset me përkushtimin më të madh për shtëpinë, i edukon fëmijët në Islam, përgatit ushqim për të gjithë familjen, e pastron shtëpinë dhe tërë familjen, dhe ajo që është shumë me rëndësi, shikimi i saj plot dashuri e me buzëqeshje të bën të lumtur e plot gëzim, ta freskon zemrën. E lusim Allahun e Lartmadhëruar, që gratë tona t'i bëjë kënaqësi për sytë tanë dhe freskim për zemrat tona, ashtu si të jetë Ai i kënaqur. ■

INKURAJIMI PËR SJELLJE TË MIRË

15 metoda të ndryshme. Provoji këto metoda për të inkurajuar tek fëmija sjelljet që ju dëshironi.

RAISING CHILDREN NETWORK

1. Fëmijët veprojnë ashtu siç veproni ju. Fëmija ju shikon si një model për të arritur çelësin se si të sillet me botën që e rrethon, përdoreni sjelljen tuaj për ta udhëzuar atë. Se çfarë bëni është shumë më e rëndësishme, se sa ajo që thoni. Nëse dëshironi që fëmija të thotë 'ju lutem', atëherë duhet të thoni vetë ashtu. Nëse nuk dëshironi që fëmija të ngrejë zërin, mbajeni zërin tuaj gjithashtu në nivel të ulët.

2. Tregojini se si ndjeheni. Nëse arrini që t'i tregoni sinqerisht fëmijës, se si ndikon sjellja e tij tek ju, ai do të njohë ndjenjat e veta në të tuajat, si në një pasqyrë dhe do të jetë në gjendje t'ju kuptojë. Rreth moshës tre vjeçare, fëmijët mund të shfaqin dhembshuri të vërtetë. Prandaj nëse ti shprehesh: “Unë po zhgënjehem, sepse ka aq shumë zhurmë saqë nuk po mundem të flas në telefon.” Kur e fillon fjalinë me ‘Unë’, i jep kështu fëmijës rastin që

t'i shikojë gjërat nga perspektiva juaj.

3. Zëreni fëmijën tuaj, kur është duke bërë mirë. Kjo nënkupton që kur fëmija sillet në atë mënyrë që ju dëshironi, ti mund t'i japësh një reagim pozitiv, për shembull, "O sa mirë po luan. Vërtetë më pëlqen se si po i mban të gjitha blloqet sipër tavolinës". Kjo funksionon më mirë sesa të presësh që blloqet ose lodrat të bien në dysheme para se ta vësh dhe të bërtasësh: 'Ej, mos ashtu'. Ky reagim pozitiv, nganjëherë quhet **'lëvdatë përshkruese'**. Mundohu të japësh gjashtë komente pozitive (lëvdata dhe inkurajime) për çdo koment negativ (kritikë dhe qortim). Raporti 6/1 i mban gjërat në balancë. Gjithashtu më rëndësi është të mbahet parasysh, se nëse mbetet zgjidhja ndërmjet të mos-kushtuarit vëmendje, ose vëmendjes negative, fëmijët do të përpiqen për vëmendjen tuaj negative.

4. Zbrit në nivelin e tij. Duke u ulur në gjunjë ose duke ndenjtur galiç pranë fëmijës është një metodë mjaft e fuqishme për të komunikuar pozitivisht me të. Afërsia ju mundëson të kuptoni se si ai mund të ndjehet, apo se çfarë po mendon. Gjithashtu ndihmon që fëmija të fokusohet se çfarë po i thoni atij, apo çfarë po kërkon nga ai. Nëse jeni afër tij dhe e keni vëmendjen të përqendruar tek ai, nuk ka nevojë të kërkon që ai t'ju shikojë.

5. 'Po të dëgjoj.' Dëgjimi aktiv është një metodë tjetër për t'i ndihmuar fëmijët që të përballen me emocionet e tyre. Ata priren të jenë mjaft të frustruar, veçanërisht nëse nuk mund të shprehin aq sa ju mjafton përmes të folurit, prandaj nëse ia përsërisni me fjalë atë që ndoshta mendoni se ai ndjen, e ndihmon që të nxjerrë jashtë atë që ai ndjen dhe e bën fëmijën të ndjehet i respektuar dhe i rehatuar. Kjo mund të largojë mjaft zemërimin e mundshëm.

6. Mbajti premtimet. Qëndro besnik në

marrëveshje. Kur i përmbahesh premtimeve të tua, të mira apo jo të mira, fëmija mëson të ketë besim dhe respekt ndaj jush. Prandaj nëse i premtoni fëmijës që pasi t'i mbledhë lodrat do të shkoni për një shëtitje, sigurohuni që t'i keni të gatshme këpucët për shëtitje. Nëse ti i thua atij, që nëse nuk e ndalon vrapimin sa andej-këndeje do të largohem menjëherë nga biblioteka dhe fëmija vazhdon të vrapojë, atëherë përgatituni që të largoheni menjëherë. Nuk ka nevojë të bëni rrëmujë - sa më praktik të jeni, aq më mirë është. Kjo bën që fëmija të ndjehet më i sigurt, pasi kështu krijon një ambient të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm.

7. Zvogëlo cytjet. Syzet tuaja mund të jenë mjaft tërheqëse për të luajtur - një fëmijë me vështirësi e sjell ndërmend se duhet ta ndalojë vetveten nga gjësende të tilla. Zvogëlo shanset për fëmijët e pafajshëm detyrimi për të cilin është përkujdesja, që të gjitha këto gjësende të mbahen larg shikimit të tij.

8. Zgjidhi betejat e tua. Para së të ndërhyti në çfarëdo gjë që fëmija është duke bërë, pyete veten, nëse ia vlen të ndërhysh apo jo! Duke iu përmbajtur udhëzimeve, kërkesave dhe reagimeve negative deri në minimum, ju do të krijoni kështu më pak mundësi për një konflikt, ose ndjenja jo të këndshme. Rregullat janë të rëndësishme, por ruaji ato për çështje më të rëndësishme.

9. Të qarit: bëhu e fortë. Fëmijët nuk dëshirojnë të jenë të bezdisshëm. Nëse lëshojmë pe' nga të qarit e tij këmbëngulës, atëherë pa dashje jemi duke e mësuar fëmijën që të veprojë gjithnjë në atë mënyrë. **'Jo'** do të thotë 'jo', e nuk do të thotë 'ndoshta', prandaj mos thuaj **'jo'** përderisa nuk nënkupton **'jo'**. Nëse thua jo, pastaj dorëzohesh, atëherë fëmijët herët e tjera me shpresën se do të fitojnë prapë, do të jenë

edhe më këmbëngulës në të qarit e tyre.

10. Rri e qetë dhe pozitive. Nëse jep udhëzime të qarta me fjalë të thjeshta, fëmija do të kuptojë se çfarë pritët nga ai. ('Të lutem ma jep dorën derisa të kalojmë rrugën në anën tjetër.') Trajtimi i çështjeve në mënyrë pozitive bën që fëmijët të kuptojnë mirë: 'Të lutem mbylle portën', është një shprehje më e mirë sesa 'Mos e lër portën hapur'.

11. Përgjegjësitë dhe pasojat. Ndërsa fëmija rritet më tepër, mundet që gjithnjë e më shumë t'i jepni përgjegjësi për sjelljen e tyre dhe rastin për të përjetuar pasojat natyrale të sjelljeve të tyre. Nuk është e nevojshme që gjithnjë të jeni person i pakëndshëm. Për shembull, nëse fëmija ka harruar ta fusë drekën në çantën e tij, atëherë ai do të ketë uri në kohën e drekës. Është uria e tij që ndikon me pasojat e saj në sjelljen e tij, dhe nuk do ta dëmtonte të qëndrojë i uritur vetëm një herë. Nganjëherë duke pasur synime të mira bëjmë aq shumë për fëmijët tanë, sa që nuk u japim rastin të mësohen vetë. Në rastet e tjera duhet të parandaloni sjelljet me pasoja të papritura dhe të rrezikshme. Për këso raste është mirë që të siguroheni se i keni sqaruar mirë pasojat dhe se fëmija i ka pranuar ato që më parë.

12. Thuaj një herë dhe lëre. Është e habitshme se si fëmija dëgjon, edhe pse nuk është i pjekur për ta shprehur. Të kërcënuarit dhe të kritikuarit e vazhdueshëm ndaj tij është i mërzitshëm për ju, por edhe nuk funksionon. Fëmija vetëm do të përfundojë në mosdëgjimin ndaj jush dhe habitet pse jeni edhe më të zhgënjyer. Nëse dëshiron që t'i japësh edhe një rast për të bashkëpunuar, tregoji atij për pasojat dhe numëro deri në tre.

13. Bëje që të ndjehet i rëndësishëm. Fëmijëve u pëlqen kur kontribuojnë në familje. Fillo duke e angazhuar me disa punë

“'Jo' do të thotë 'jo', e nuk do të thotë 'ndoshta', prandaj mos thuaj 'jo' përderisa nuk nënkupton 'jo'...”

të thjeshta shtëpie, ose me diçka që ai mund të bëjë për të luajtur rolin e tij të rëndësishëm në të ndihmuarit në shtëpi. Kjo do ta bëjë të ndjehet i rëndësishëm dhe të krenohet për ndihmën e ofruar. Nëse i jepni rastin fëmijës, që të bëjë sa më shumë praktikë në punët e shtëpisë, ai do të mësojë më shumë rreth tyre dhe do të provojë edhe më shumë përkushtim. Punët jo të dëmshme për fëmijën e ndihmojnë të ndjehet përgjegjës, të formojë vetërespekt dhe ju ndihmon juve gjithashtu.

14. Përgatite për situata sfiduese. Ka çaste kur kujdesi për fëmijën tuaj dhe bërja e punëve që ju keni nevojë t'i bëni ju sjell në një situatë të ndërlikuar. Nëse mendoni për këto situata sfiduese më para, atëherë mund të planifikoni rreth nevojave të fëmijës tuaj dhe ta paralajmëroni për ndryshimin e orarit, duke i treguar atij se për çfarë arsye u nevojitet bashkëpunimi me të. Atëherë fëmija do të jetë i përgatitur se çfarë po prisni nga ai.

15. Shfrytëzo ndjenjën e humorit. Një mënyrë tjetër për largimin e zemërimit, ose të një konflikti të mundshëm është përdorimi i humorit. Bëni sikur jeni një vigan i trembur dhe i kilikosur, ose imito zëra kafshësh. Sidoqoftë humori në kurriz të tij, nuk ndihmon; fëmijët e vegjël lëndohen mjaft lehtë nga 'ngacmimet' prindërore. Humori më i mirë është ai që u bën të qeshni të dyve. ■

Përktheu: Pakize Krasniqi

LLUKMANI ALEJHI SELAM - SHEMBULL PËR UDHËZIMIN E FËMIJËVE

Në këtë artikull do të mundohem që t'u ofroj atyre prindërve, të cilët dëshirojnë që fëmijëve të tyre t'u japin edukatë të shëndoshë një pasqyrë se si Islami e ka projektuar këtë çështje.

AUTORI: MUHAMED XHEMIL ZEJNO

Secili prind apo edukator mundohet që të jetë sa më i suksesshëm në edukimin e fëmijëve të tij. Mirëpo për të qenë i suksesshëm duhet që të ketë referenca të mira, të cilat do ta ndihmojnë në punën e tij. Por referencë më të mirë se ajo hyjnore nuk ka. Për këtë temë mund të flasim pedagogët, sociologët e të tjerë. Në këtë artikull do të mundohem që t'u ofroj atyre prindërve, të cilët dëshirojnë që fëmijëve të tyre t'u japin edukatë të shëndoshë një pasqyrë se si Islami e ka projektuar këtë çështje.

1- Allahu subhanehu ue teala në Kuranin Famëlartë thotë: "(përkujtoje popullin tënd) **Kur Llukmani duke e këshilluar birin e vet i tha: "O djali im, mos i përshkruaj Allahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe!"** Llukman 13. Me këtë këshillë Llukmani alejhis selam i bëri me dije djalit të tij, se shirku është prej mëkateve më të mëdha dhe se ai duhet të ruhet nga ky mëkat, që mos të bjeri në te. Kur u shpall ajeti kuranor: **"Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me besim të kotë".** El-En'am 82, e pyetën Muhamedin, salallahu alejhi ue selem: E kush nga ne nuk i bën padrejtësi vetvetes?! Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, tha: Jo, por qëllimi është shirku. A nuk i keni dëgjuar fjalët e Llukmanit alejhi selam, kur i tha birit të vet: **"O djali im, mos i përshkruaj Allahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe!"**



Llukman 13.

2- **"Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindit të vet, sepse nëna e vet e barti atë me mund pas mundi dhe pas dy viteve ia ndau gjirin.** (E porositëm) **Të jesh mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve të tu, pse vetëm tek Unë është kthimi juaj."** Llukman 14.

Ibën Kethiri, Allahu e mëshiroftë thotë: Pasi e këshilloi birin e tij për rrezikun e shirkut, ai i dha këshillën e dytë e ajo është

respektimi i prindërve nga pesha që ka, sepse nëna e ka mbajtur me mundime të mëdha, kurse babai është kujdesur për furnizimin e tij. Në këtë rast ia ka bërë me dije, se nëse nuk i respekton prindërit bën mëkat të madh.

3- ***“E nëse ata të dy përpiqen që ti të më përshkruash Mua shok, për çfarë ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote të kesh mirëkuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer nga Unë, mandej kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t’ju njoftoj për atë që keni punuar”***. Llukman 15. Nëse ata përpiqen që ti të ndjekësh fenë e tyre (nëse ata nuk janë muslimanë), atëherë nuk duhet t’i respektosh. Ndërsa për punë të tjera mundet t’i ndihmosh atyre dhe të sillësh mirë me ta. Këtë e vërteton edhe Muhamedi, alejhi salatu ue selem, kur thotë: ***“Nuk duhet respektuar krijesa, për t’i bërë mëkat Krijuesit”***. (Muttefekun alejhi).

4- ***“O djali im, s’ka dyshim se edhe nëse ajo (vepra) peshon sa kokrra e lirit, e të jetë e fshehur nën rrasën e gurit, ose në qiej, apo në tokë, Allahu do ta sjellë atë, se Allahu është i butë dhe hollësisht i informuar”***. Llukman 16.

Ibën Kethiri, Allahu e mëshiroftë, kur e komenton këtë ajet thotë: Nëse vepra që bën ti, qoftë e madhe apo e vogël, Allahu subhanehu ve tealë, kur t’i vendosë veprat në peshore, do t’i sjellë të gjitha qoftë e vogël apo e madhe. Nëse është e mirë do të shpërblehesh e nëse është e keqe do të dënohesh.

5- ***“O djali im, fale namazin...”*** Llukman 17. d.m.th. fale atë me të gjitha pjesët përbërëse dhe me frikë.

6- ***“Urdhëro për punë të mira, e ndalo nga të këqijat...”***. Llukman 17. Duke qenë i kujdesshëm dhe me mençuri.

7- ***“...përballo me durim çdo gjë që të godet...”*** Llukman 17. Ia bëri me dije, sepse të urdhërosh për të mira dhe të ndalosh nga e keqja përballohesh me vështirësi e ato duhet

t’i kalosh me mençuri. Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, thotë: ***“Besimtari që shoqërohet me njerëz dhe i duron keqtrajtimet e tyre është më i mirë se besimtari që nuk përzihet me njerëz dhe nuk i duron keqtrajtimet e tyre”***.

Vazhdon ajeti: ***“këto janë nga çështjet më të preferuara”***. Llukman 17. d.m.th., Nëse ti përzihesh me ta dhe je durimtar është prej punëve më të preferuara.

8- ***“Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve...”***. Llukman 18. Ibën Kethiri Allahu e mëshiroftë thotë: Kur të flasësh me njerëz mos e shtrembëro fytyrën nga mendjemadhësia apo nga mburrja, por të jesh i buzëqeshur me ta. Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, thotë: ***“T’i buzëqeshësh vëllait tënd është lëmoshë.”*** E përcjell Tirmidhiu.

9- ***“Mos ec nëpër tokë kryelartë...”***, d.m.th., mos ec me kokën lart nga mendjemadhësia dhe mburrja, sepse këtë ves nuk e do Allahu e as që e dëshirojnë njerëzit: ***“se Allahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet.”***

10- ***“Të jesh i matur në ecjen tënde...”*** Mos ec ngadalë nga përtacia e as shpejt, por gjej mesataren ndërmjet ecjes shpejtë dhe ngadalë.

11- ***“...ule zërin tënd...”*** mos e ngre zërin pa nevojë dhe mos u bëj që të dëgjohet vetëm zëri yt e të dominojë mbi të tjerët ***“se zëri më i egër është zëri i gomarit...”***. Llukman 19.

Muxhahidi thotë: Zëri më i lartë dhe më i padëshiruar është zëri i gomarit. Këtë zë e urren Allahu, subhanehu ue tealë, si dhe njerëzit. Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, thotë: ***“Kur ta dëgjoni zërin e gjelit luteni Allahun, që t’u japë nga të mirat e tij, sepse ai ka parë melekun. Ndërsa kur të dëgjoni zërin e gomarit kërkoni mbrojtje nga Allahu, sepse ai ka parë djallin”***. (Muttefekun alejhi). ■

Përshtati nga arabishtja: Enver Azizi



HUTIMI PAS DYNJASË

Koment i sures Tekathur

Bismilahi Rrahmani Rrahim

“Elhakumut tekathur. Hatta zurtumul mekabir. Kel-la seufe ta’lemun. Thumme kel-la seufe ta’lemun. Kel-la leu ta’lemune ilmel jekin. Leteraunnel xhehim. Thumme leteraunneha ajnel jekin. Thumme letus’elunne jeume idhin anin neim”.

Në emër të Allahut, Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

“Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar, derisa të vizitoni varret. Gjithsesi do ta merrni vesh! Madje, së shpejti do ta

merrni vesh! Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri! Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues! Pastaj me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë. Pastaj atë Ditë do të pyeteni për

kënaqësitë (e kësaj bote)!”

Muhamed b. Utthejmin

“Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar, derisa të vizitoni varret”, kjo është një fjali dëftore nëpërmjet së cilës, Allahu ua bën me dije njerëzve se janë preokupuar me gjëra të ndryshme, saqë janë hutuar nga ato më të rëndësishmet, siç janë përmendja e Allahut dhe respekti ndaj Tij. Kjo vërejtje vlen për të gjithë njerëzit, përveç atyre që janë preokupuar me respektin ndaj Allahut, saqë kanë harruar punët e kësaj dynjaje, por këta janë shumë pak. Themi se janë pak, sepse në të Dy Sahihët vërtetohet se Allahu në Ditën e Kiametit do të thotë: **“O Adem!... - Të përgjigjem Ty me plot gëzim, e gjithë mirësia është te Ti** – do të thotë Ademi, alejhi selam. **Merr një grup nga pasardhësit e tu për t’i çuar në xhehenem** – do ta porositi Allahu. **Por, sa janë ata?** – do të pyesë Ademi, alejhi selam. **Nga çdo një mijë, janë nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë** – do të thotë Allahu.” Vetëm një në xhenet, e të tjerët në Zjarr, ky është një numër marramendës! Meqë prej një mijëve shpëton vetëm një, do të thotë se kjo vërejtje u drejtohet të gjithëve, sepse tërë ata njerëz do ta shohin Zjarrin.

“rivaliteti për të shtuar” nënkupton rivalitetin në shtimin e pasurisë, të familjes, të famës, të dijes dhe të gjithçkaje me të cilat mund të mburret dikush. Njëri kërkon rivalitetin duke shtuar pasurinë, që të ketë më shumë para dhe biznes më të madh se tjetri, tjetri kërkon rivalitetin duke shtuar fisin e tij për të thënë: Ne jemi në numër më të madh se ju! I treti, mundohet të përfitojë më shumë dije se tjetri e kështu me radhë. Nëse bëhet fjalë për shtimin e dijes fetare,

kjo është hair, por sa i përket dijeve të tjera, ky lloj shtimi mund të jetë i lejuar, por edhe i ndaluar. Këto janë gjërat, ku njerëzit më së shumti futen në rivalitet.

“derisa të vizitoni varret”, d.m.th., derisa të vdisni, sepse njeriu mundohet t’i shtojë këto gjëra derisa të vdesë, madje sa më në moshë shtyhet, aq më shumë dëshira ka, i moçëm në vjet, por i ri në shpresa, prandaj mund të takosh një plak nëntëdhjetë vjeçar me dëshira dhe shpresa që zakonisht mund t’i gesh te një i ri pesëmbëdhjetë vjeçar. Pra, kuptimi i ajetit është: **“Ju jeni hutuar pas rivalitetit për të shtuar saqë ju arriti vdekja”.**

Kjo pjesë e ajetit gjithashtu është argument se ringjallja është realitet, sepse kur njeriu viziton diçka, d.m.th. shkon tek ajo dhe pastaj kthehet. E kur njeriu viziton varret, d.m.th. do të kthehet, por ku? Do të kthehet tek Allahu pasi të ringjallet. Nga kjo gjë kuptojmë gabimin që e dëgjojmë nëpër media të ndryshme, kur lajmërojnë vdekjen e dikujt: “U vendos në banesën e tij të fundit”. Kjo shprehje është e kotë dhe rrenë, sepse varret nuk janë banesa e fundit. Ai njeri që beson ndryshe, ai veçse e ka mohuar ringjalljen dhe nuk është musliman. Mirëpo njerëzit marrin të shkruajnë dhe nuk dinë se çfarë kanë shkruar dhe kanë thënë, ata thjeshtë ndikohen nga jobesimtarët, që nuk besojnë në ringjalljen. Prandaj është detyrë t’i largohemi kësaj shprehje, sepse varri nuk është banesa e fundit, por banesa e fundit është xheneti ose xhehenemi.

“Gjithsesi do ta merrni vesh! Madje, së shpejti do ta merrni vesh!”, pra, do ta merrni vesh fundin e çështjes suaj, kur do të ktheheni në ahiret dhe do të bindeni se

¹ Buhariu (6530), Muslimi (222)

² Muslimi (2958)

“Edhe kafiri, edhe myslimani, të gjithë do të pyeten për kënaqësitë...”

ky rivalitet nuk do t’ju bëjë dobi. Kjo na bëhet e qartë edhe nga hadithi, ku i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Biri i Ademit thotë: – duke u krenuar – malli im, pasuria ime. Mirëpo – dije – se pasuria jote nuk është ndryshe përveç ushqim që harxhohet, ose veshmbathje që shqyhet, ose sadaka që mbetet gjithmonë”*.² Ndërsa tjetra i mbetet dikujt tjetër dhe kjo është realitet, sepse pasurinë tonë ose e hamë dhe s’mbetet gjë prej saj, ose e përdorim për veshmbathje dhe asgjësohet më vonë, ose e japim sadaka dhe kështu e bëjmë të përhershme, duke e gjetur atë në Ditën e Kiametit. Ose ua lëmë të tjerëve. **“Madje, së shpejti do ta merrni vesh!”** edhe një herë thekson se të gjithë do ta merrni vesh fundin e çështjes suaj.

“Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri!”, d.m.th., me të vërtetë sikur ta dinit këtë gjë me bindje, ju do ta shihnit se jeni në të pavërtetën, mirëpo ju nuk e dini këtë gjë me bindje, sepse ju jeni të përgjumur dhe të hutuar pas dynjasë, përndryshe do të bindeshit se jeni në gabim të madh.

“Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues! Pastaj me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë”. Kjo fjali është e re dhe nuk është si përgjigje për ajetin paraprak. Prandaj kur ta lexosh: *“Kel-la leu ta’lemune ilm el jekin - Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri!”*, aty duhet të ndalesh e pastaj të vazhdosh: *“Leteraunnel xhehim - Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues!...”*. Ndërsa sot, i

dëgjojmë shumë prej lexuesve që i bashkëngjisin këto dy ajete dhe e lexojnë: *“Kel-la leu ta’lemune ilm el jekin. Leteraunnel xhehim...”*, por këtë e bëjnë, ose nga padija, ose nga harresa, ose nuk kanë menduar më thellë rreth këtij ajeti, sepse sikur të meditonin më shumë do ta mësonin se kjo bashkëngjitje ia prish kuptimin, sepse kur të thuash: **“Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri! Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues”**, me këtë nënkupton se shikimi i Zjarrit është i kushtëzuar me dijen e të vërtetës, gjë e cila nuk është e vërtetë. Pra, kujdes me këtë gjë dhe t’ua tërheqim vërejtjen të tjerëve. Kur të dëgjosh dikë duke lexuar: *“Kel-la leu ta’lemune ilm el jekin. Leteraunnel xhehim... (bashkë)”*, tërhiqja vërejtjen duke i thënë: O vëlla, kjo ngjitje e ajeteve mund t’ia prishë kuptimin e vërtetë ajeteve, mos i ngjit pra, sepse fillimisht janë ajete të ndara, dhe më mirë është që çdo ajet të lexohet veçmas, dhe së dyti: Kjo ngjitje e prish kuptimin e ajeteve.

Xhehimi apo Zjarri flakërues, siç e kemi përkthyer është një prej emrave të xhehenemit.

“Pastaj me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë”, këtu përforcohet pohimi, se xhehenemi do të shihet, por kur do të shihet? Do të shihet në Ditën e Kiametit, kur do të sillet duke u tërhequr zvarrë me 70,000 mijë kapistra, çdo kapistër tërhiqet nga 70,000 melekë. Çfarë mund të thuash pra, për këtë zjarr – Allahu na ruajtë – aq të madh, i cili tërhiqet me 70,000 kapistra, e në çdo kapistër nga 70,000 melekë, ndërsa e dimë se melekët janë krijesa të mëdha e të fuqishme. Ky zjarr pra, është shumë i madh, o Zot na ruaj prej tij.

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote!)” d.m.th. në atë

kohë, në atë situatë të vështirë do të pyeteni për të mirat. Kush do të pyetet, kafiri; apo edhe kafiri, edhe myslimani? Për këtë dijetarët kanë mendime të ndryshme.

E sakta: Do të pyetet, edhe kafiri, edhe myslimani, të gjithë do të pyeten për kënaqësitë, me përjashtim të asaj që kafiri do të pyetet për t'u qortuar dhe nënçmuar, ndërsa besimtari do të pyetet për t'u rikujtuar. Argumenti se do të pyeten që të gjithë është ngjarja e Resulullahut, salallahu alejhi ue selem, me Ebu Bekrin dhe Omerin, radijallahu anhuma. Ebu Hurejra, radijallahu anhu, rrëfen se një ditë apo një natë kishte dalë i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, dhe i takoi Ebu Bekrin dhe Omerin, radijallahu anhuma, dhe i pyeti: *“Ç’është ajo që ju nxori nga shtëpia në këtë kohë?”* Uria, o Resulullah – u përgjigjën ata. *“Gjithashtu edhe mua, pasha atë në dorë të Kujt është shpirti im, edhe mua më nxori ajo që u nxori juve, ejani”*. Ata shkuan me të dhe së bashku u drejtuan te njëri prej ensarëve, por ai nuk ishte në shtëpi, kur i pa e shoqja, iu tha: Mirë se vini, urdhëroni! I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, e pyeti: Ku është ai? Shkoi që të sjellë ujë të pijshëm – u përgjigj ajo. Pas pak erdhi ensari dhe e pa të Dërguarin, salallahu alejhi ue selem, së bashku me dy shokët e tij dhe tha: I lavdëruar është Allahu, askush nuk ka sot mysafirë më të ndershëm sesa unë. Ai shkoi menjëherë dhe solli një enë me hurma të thata, gjysmë të thata dhe të njoma dhe u tha: Hani këtu! Pastaj mori thikën, ndërsa Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, i tha: *“Kujdes, mos ther ndonjë me qumësht”*, dhe ai theri një dele. Hëngrën që të gjithë nga ai mish dhe ato hurma,

“...Tek republikanët nuk ka njeri që të shprehi ndonjë interesim për amerikanët myslimanë, ndërsa te demokratët është e qartë se Hilari Klinton nuk gëzon aspak autoritet te myslimanët, sepse shumica e tyre nuk i besojnë asaj...”

pastaj pinë. Pasi u ngopën mirë dhe shuan etjen, i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, iu drejtua Ebu Bekrit dhe Omerit, radijallahu anhuma: *“Pasha Atë në dorë të Kujt është shpirti im, për këto kënaqësi do të pyeteni Ditën e Kiametit. Nga shtëpia ju nxori uria dhe tani po ktheheni pasi përjetuat këtë kënaqësi”*.³

Ky hadith është argument, se do të pyetet edhe kafiri edhe besimtari, mirëpo dallon mënyra e të pyeturit. Besimtari pyetet për t'i rikujtuar begatitë e Allahut, që të gëzohet dhe t'i bëhet me dije se Ai që i dha të mira në dynja do t'i jep të mira edhe në ahiret. Pra, nëse nderohet me një të mirë në dynja, me atë të mirë do të nderohet edhe në ahiret. Ndërsa kafiri, ai do të pyetet për t'u qortuar dhe nënçmuar. E lusim Allahun të na frymëzojë në respekt ndaj Tij dhe të mirat që na ka dhënë të jenë ndihmë në respekt ndaj Tij. Ai ka mundësi të bëjë çdo gjë. ■

Përshtati: Omer Berisha

³ Muslimi 2038

DUAJE TË MIRËN EDHE PËR TË TJERËT

Enes ibën Maliku përcjell se i Dërguari Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Nuk beson askush nga ju derisa nuk dëshiron për vëllain e tij atë që dëshiron për vete”*.

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Këtë hadith e shënon imam Buhariu në Sahihun e tij me nr. 13, imam Muslimi, nr. 45, si dhe imam Ahmed dhe Ibën Hibani. Të gjitha këto transmetime janë të përafërta në fjalë, por të gjitha kanë këtë kuptim, ndërsa hadithi i lartshënuar ka fjalët e transmetimit të Buhariut.

Rëndësia e hadithit:

Ky hadith me të vërtetë ka kuptim madhështor dhe ai në vetvete mbart edukatën profetike, të cilën i Dërguari,

salallahu alejhi ue selem, ia mësoi umetit të vet. Ai tregon se sa e rëndësishme është t'ia duash të mirën vëllezërve të tu nga feja, dhe se ajo krahasohet me besimin, sa më e lartë të jetë ajo, po aq e lartë është edhe shkalla e besimit, dhe e kundërta aq sa njeriu e shikon interesin e tij personal, duke mos i kushtuar rëndësi interesit të vëllezërve nga feja, atëherë po aq është e ulët edhe shkalla e besimit. Feja jonë hyrjen në xhenet e kushtëzon me plotësimin e këtij kushti. I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, i tha një ditë shokut të tij Jezid b. Esed el-Kasiut: *“A e do xhenetin?”* Ai ia ktheu: *Po*. Atëherë Profeti, salallahu alejhi ue selem, i tha: *“Atëherë*

dëshiro për vëllanë tënd atë që do për veten". (Imam Ahmedi, 4/70.) Profeti, salallahu alejhi ue selem, me këtë fjalë dhe me udhëzimin e tij i tregon çdo njeriu që shqipton shehadetin, kushdo, dhe nga çfarëdo vendi qoftë ai, se vëllezërve të tij duhet t'ua dojë të mirën, ashtu si vetes së vet. Kjo për arsyen që secili nga besimtarët të gjejë qetësi tek vëllai i tij nga feja, ta ketë shpinën dhe familjen e sigurt nga ai. Me këtë hadith, ai i tregoi çdo besimi dhe ideologjie, se e vetmja fe në të cilën njerëzit arrijnë të bashkohen dhe ta duan njëri-tjetrin është Islami, prandaj pranojeni atë, se do të keni siguri maksimale, nga Zoti, nga shteti islam, në këtë botë nga telashet dhe në botën tjetër nga zjarri, gjithashtu edhe nga muslimanët, pra, të jeni të sigurt në çdo kohë dhe në çdo vend dhe nga çdokush. Ai me këtë udhëzim i tregoi botës se Islami e trajton vëllanë në fe shumë më mirë se çdo ideologji. Atë dashuri dhe respekt që arrin ta mbjellë feja jonë mes muslimanit nga lindja e botës e tjetrit nga perëndimi i saj, nuk mund ta mbjellë askush mes dy personave të dalë nga barku i një nëne.

Komentimi i hadithit:

Fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem: *"Nuk ka besuar"*

Në shikim të parë njeriu mendon se me mohimin e besimit nga njeriu që nuk sillet mirë me vëllezërit e tij besimtarë është si qëllim dalja e tij nga feja. Mirëpo ky mendim nuk qëndron, sepse vetë i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, një gjë të tillë nuk e ka pasur si qëllim. Ai në transmetimin e imam Ahmedit tregon qëllimin e tij me këtë fjalë, kur thotë: *"Njeriu nuk arrin shkallën e plotë të besimit derisa nuk ia do vëllait të tij atë të mirë që ia do vetes së vet"*, pra, me fjalën e tij *"nuk ka besuar"* nuk është si qëllim mohimi i shkallës së plotë të besimit dhe nuk nënkupton se mos-sjellja e mirë me të tjerët do të thotë mosbesim total. Shprehje të

ngjashme nga i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, janë përmendur shpesh nëpër disa hadithe të tij, në të cilët ai kritikon mëkatarrët dhe ua tërheq vërejtjen besimtarëve nga mëkatet e mundshme. Ndër ato hadithe është edhe fjala e tij: *"Njeriu kur bën amoralitet, nuk mund të jetë besimtar në çastin e aktit të amoralitetit, vjedhësi nuk mund të jetë besimtar në çastin e vjedhjes dhe alkool-pirësi nuk mund të jetë besimtar në çastin e pirjes së alkoolit."* (Shënon Buhariu, nr. 2475 dhe Muslimi, nr.57.)

Si shkak i kësaj fjale dijetarët më vonë janë ndarë në dy mendime, se mëkatari, i cili bën mëkate të mëdha: a e meriton cilësimin **"mumin – besimtar"**, apo vetëm atë **"muslim – mysliman"**, duke e ditur se gradët e besimtarëve janë tri: e para **"muhsin – bamirës"**, e cila është më e vlefshme, e dyta **"mumin"**, e cila është më e ulët se e para dhe më e ulëta e tyre ajo e treta **"muslim"**. Disa nga ata e lejuan t'i thuhet mëkatarrit, i cili ka rënë në mëkate të mëdha dhe akoma nuk është penduar **"mumin me iman të dobët"**. Kurse grupi tjetër i tyre këtë lloj njeriu e quajtën me epitelin më të ulët, pra, atë të tretin **"muslim"**. Të dy grupet e dijetarëve janë nga dijetarët e Ehli Sunetit dhe secili ka argumentet dhe arsyetimet e veta, mirëpo nëse ndalemi dhe i analizojmë të dy mendimet e tyre shohim se janë të përafërta dhe nuk kanë ndonjë dallim ekstrem, sepse edhe ata që e lejuan të quhet ky njeri me emrin **"mumin"** e kushtëzuan atë me sqarimin e mëpasshëm, i cili thotë: **"mumin me iman të dobët"**.

Sa i përket besimtarit, i cili bën mëkate të vogla dhe largohet nga ato të mëdhatë, nuk ka dyshim se nuk largohet nga epiteli **"mumin"**.

Pra, besimi i ngjan një petku, të cilin kur e vesh njeriu sa më tepër t'i shtojë stof, aq më tepër do t'i mbulohet trupi, ndërsa aq sa ta mungojë atë, aq më tepër i zbulohet trupi.

“Sa i përket vetive dhe punëve të tyre të mira, pa dyshim se ato as jomuslimanëve nuk do t’u shkojnë huq, ata do të shpërblehen për ato punë...”

Kështu edhe imani sado t’i shtosh adhurimet, imani do të shtohet e sado që njeriu futet në mëkate, aq edhe zhvishet nga besimi.

“Askush nga ju”

Me këtë fjalë të Resulit salallahu alejhi ue selem, së pari përfshihen sahabët e pas tyre të gjithë besimtarët kudo ku janë në botë. Pra, me të janë si qëllim vetëm muslimanët e jo kafirët, kjo për dy shkaqe, **e para** për faktin se i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, me këtë fjalë iu drejtua besimtarëve dhe **e dyta** kafirët e patën këtë veti apo jo, ata në të dyja rastet janë jobesimtarë. Gjithashtu hyrja e tyre në xhenet së pari kushtëzohet me besim e pastaj vijnë punët tjera, siç janë respektimi i të tjerëve, mirësjellja ndaj tyre etj., dhe se nuk do të thotë që ata nëse ua duan të mirën të tjerëve, kjo nënkupton edhe futjen e tyre në xhenet duke mos qenë muslimanë. Kjo assesi nuk do të ndodhë me asnjë jobesimtar, pa marrë parasysh sa është i sjellshëm dhe human me të tjerët. Hyrja në xhenet është e kushtëzuar me hyrjen në Islam dhe praktikimin e tij, sepse feja e vetme e pranuar tek Zoti është Islami. Sa i përket vetive dhe punëve të tyre të mira, pa dyshim se ato as jomuslimanëve nuk do t’u shkojnë huq, ata do të shpërblehen për ato punë, mirëpo ky shpërblim do të jetë në këtë botë, siç është arritja e autoritetit, pozitës, pasurisë, mirënjohjes nga të tjerët etj. E nuk do t’u mbetet asnjë e mirë për në botën tjetër. Këtë

rregull që përmendëm është një fakt i gjallë, të cilin e vërejmë tek shumë njerëz të kohës apo shekullit tonë, të cilët me të vërtetë kanë qenë të mirësjellshëm, humanë dhe të interesuar për të tjerët, mirëpo e kanë marrë shpërblimin e tyre në këtë botë duke i quajtur me emrat e tyre shkollat, rrugët dhe institucione të tjera, apo duke u ndërtuar përmendore dhe të ngjashme me to, në kujtim të tyre. Ai ka qenë shpërblimi i Zotit për ta dhe nuk u ka mbetur asgjë për botën tjetër.

“Derisa nuk dëshiron për vëllanë e tij”

Me fjalën “vëlla” është si qëllim vëllai nga feja, pra, besimtari. I Dërguari fjalën “vëlla” e përmend në mënyrë të përgjithshme, që të na japë me këtë fjalë të kuptojmë se besimtarin e ke vëlla, pa marrë parasysh kush është ai, apo nga është dhe cila ka qenë historia jote më herët me të. Ky njëherazi është edhe udhëzim i Allahut të Lartësuar, që i quan besimtarët ndërmjet tyre vëllezër. Ai thotë: **“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër.”** Huxhurat, 10.

Edhe pse tek ne apo edhe në vende të tjera të botës fjala vëlla nënkupton vëllanë nga babai e nëna, apo nga njëri prej tyre, në Islam prioritet më të madh i kushtohet atij nga feja e sidomos nëse ai nga prindërit nuk është musliman. Mirëpo nëse vëllai nga prindërit është besimtar, atëherë ai ka dy të drejta tek vëllai i vet, atë të gjakut dhe atë të fesë.

“Atë që dëshiron për vete”

Me këtë fjalë është si qëllim t’ia duash të mirën vëllezërve, siç ia do vetes tënde, e jo të mos duash për ta çdo gjë që do për vete. Këto që po i themi i sqaron hadithi i të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, në të cilin thotë: **“Njeriu nuk arrin shkallën e plotë të besimit derisa nuk ia do vëllait të tij atë të mirë që ia do vetes së vet”.** (Ahmedi.)

Të duash për të tjerët atë të mirë që do për veten, me të vërtetë që është shkallë e lartë e besimit, e cila nuk mund të arrihet lehtë. Ajo vërehet vetëm tek besimtarët e sinqertë, të

cilët e kanë edukuar veten e tyre me shumë ngulm dhe kanë arritur të zotërojnë epshet e veta, të cilat gjenden në zemrën e çdo njeriu. Kjo ka qenë cilësi e besimtarëve të hershëm, të cilët para se ta bënë një punë ndaleshin së pari dhe e mendonin: a do të ishte mirë sikur të njëjtën gjë t'ua bënte tjetërkush atyre. Nëse u pëlqente e vepronin, kurse në të kundërtën jo. Aq shumë kishin kujdes t'ua donin të mirën vëllezërve të tyre, sa edhe kur shisnin ndonjë kafshë, e cila nuk i bënte rehat, atij që donte ta blinte ia tregonin çdo dobësi dhe i thoshin: “unë po e shes, sepse nuk jam i kënaqur vetë me të e ti nëse dëshiron merre e nëse nuk dëshiron atëherë lëre”.

Është kusht që vëllezërve t'ua dëshirosh të mirat e kësaj bote, si dhe ato të botës tjetër. Nuk duhet pasur aspak zili mes vete, përkundrazi nëse vëllai besimtar ngec ai duhet ndihmuar, që të arrijë nga mirësitë e të dy botëve, aq sa ke arritur ti e edhe më shumë. Kjo, nëse ata janë mbrapa teje në këto gjëra, e nëse ndodh të jenë para teje, atëherë besimtari në çështjet e fesë duhet të mundohet t'i arrijë ata, bile të bëhet më i mirë sesa ata, sepse gara në fe për vepra të mira është prej mësimave islame dhe punëve të ndershme. Sa i përket çështjeve të kësaj bote besimtari duhet të kënaqet me atë që i ka caktuar Allahu, mirëpo edhe nëse angazhohet për t'i arritur ato, atëherë kjo do të ishte e lejuar, nëse një angazhim i tillë do ta ndihmonte për ngritjen e devotshmërisë dhe nuk do ta pengonte në kryerjen e detyrimeve fetare. Zoti na bëftë të gjithëve prej atyre që ia duam të mirën të tjerëve siç ia duam vetes sonë! Amin! ■

PREZANTIM I LIBRIT:

SULLTANI I FUNDIT

SEDAT SHABANI

Romani në fjalë ka në qendër të vëmendjes periudhën e fundit të Perandorisë Osmane, ku autori në formën e kujtimeve të sulltanit të madh Abdyl Hamid II, i emërtuar me disa epitete si: “Sulltani i Kuq”, “Sulltani i Mallkuar”, “Abdyli i mallkuar”, “Zotëri i madh” e deri te “Kalifi i drejtë” nga ana e muslimanëve, përshkruan në mënyrë të shkëlqyer ngjarjet e perandorisë, brenda oborrit perandorak, traditat e tyre, lidhjet familjare, mënyrën e sundimit perandorak, perandori e cila u emërua nga të huajt “I Sëmuri i Bosforit”, flet për përpjekjet e shumë faqebardhëve të shpëtojnë atë që më përpara e kishte shkatërruar tjetërkush.

Ky libër me stilin e tij tërheqës të fut dhe të kthen në atë kohë, ku të duket vetja se je njëri nga aktorët e ngjarjeve që përshkruhen, të jetosh në Orient dhe të dëgjosh nga afër mënyrën e të bërit politikë brenda pallatit të “Dollmabahçes”, si dhe bisedat e takimet me ambasadorë të shteteve vendimmarrëse Anglisë,

Roman historik
Autor: Mishel De Gres
Përktheu: Miço Gubera
Boton: Plejad 2005

Rusisë etj.


Në këtë roman lexon për atentatin e dështuar mbi sulltan Abdylhamidin të organizuar nga armenët nëpërmjet një shtetasit belg, konfliktin e sulltanit me armenët, gjë për të cilën në ditët tona ka shkruar edhe nobelisti turk Orhan Pamuk...

Ajo që zgjon kureshtjen e lexuesit shqiptar, edhe ma merr mendja se është qëllimi i përkthimit të librit në gjuhën shqipe; është roli i Ismail bej Qemalit, si burrë i mirë, i cili së bashku me sulltanin përpiqet të shpëtojë anijen, e cila kishte filluar të fundosej.

Para pak ditësh lexova në revistën Klan një shkrim të Zafina Hasanit në lidhje me këtë libër, andaj po e citoj më poshtë:

“Sulltani i fundit”, përmes kujtimeve të Abdyl Hamidit II, të mbledhura në këtë libër historik nga Mishel De Gres, na sjell ditët e fundit të Perandorisë Osmane. Ato nisin me ardhjen në pushtet të atij që do të njihej jo vetëm prej emrit të tij, por dhe si “Sulltani i kuq”, “Abdyli i Mallkuar”, “Zotëri i madh”.

Shëndeti i rënduar i sulltan Muratit do të ngjiste në fron këtë vëlla të vogël të tijin. Ai vetë ka rrëfyer në libër: “Duke mos qenë në gjendje Murati të drejtonte punët, të gjithë nisen të mendonin se nuk



mund të vazhdohej kështu. Kur punët shkuan deri në këtë pikë, ambasadori i Anglisë, sër Henri Eliot, thirri në vilën e tij bashkëpunëtorin më besnik të Mit'hat Pashës, Ismail bej Qemalin, për t'i shpjeguar domosdoshmërinë për të gjetur një zgjidhje urgjente ligjore të situatës shumë të ndërlikuar të krijuar nga sëmundja e sulltanit”, kujton vetë Abdyl Hamidi. Pasi ambasadori anglez u kishte dhënë këtë këshillë (që në të vërtetë ishte një paralajmërim), përmes Ismail Qemalit qeverisë për pamundësinë e vazhdimit të funksionimit, ministrat vendosën të thërrisnin për konsultë një nga psikiatër të mëdhenj të kohës. Pasi, një prej mjekëve më të njohur të kohës, vizitoi Muratin, Ismail Qemali përhap versionin e qeverisë. Domethënë atë të Mit'hat Pashës: truri i Muratit ujësohej

gradualisht dhe megjithë mundësitë për përmirësime të lehta e të përkohshme, ishte e qartë se sulltani nuk shërohej. Ndaj në ditët e fundit të majit 1876, fronin e zuri Abdyl Hamidi II, të cilin arriti ta mbajë deri në fillimin e vjeshtës së 1912. Pastaj u largua në Çiringam, atje ku kishte lindur e ku kishte jetuar vëllai i tij, Murati. Jetoj atje deri në shkurtin e 1918-ës, kur vdiq nga një krizë në zemër.

Që Ismail bej Qemali ka pasur funksione të rëndësishme administrative në Perandorinë Osmane, që ai u shqua shumë shpejt si një prej personaliteteve më të rëndësishme të saj, që postet e tij të larta ka ditur t'i përdorë me dinakëri për të ndihmuar lëvizjen çlirimtare të bashkatdhetarëve të tij, që në kohët kur u duk qartë se një nga rrugët më të mundshme që Shqipëria të krijonte kushte të favorshme në luftën për autonominë e saj dhe për të larguar rrezikun e copëtimit të vendit ishte përmbysja e regjimit autokrat të sulltanit të fundit Abdyl Hamidit II, Ismail Qemali hyri në bashkëpunim me lëvizjen nacionale-borgjeze të turqve të rinj, që drejtohej kundër absolutizmit të sulltanit... të gjitha këto historianët tanë kanë kohë që na e kanë rrëfyer.

Ashtu siç e kanë rrëfyer qartë dhe kohët e syrgjynosjes së tij nga Porta e Lartë, shtatë vitet e internimit nëpër vende të ndryshme të Evropës, ku dhe do të krijonte lidhjet me shoqatat e ndryshme të lëvizjes shqiptare.

Ndërsa fundi i viteve '80 e rikthen sërish Ismail bej Qemalin pranë Portës së Lartë. Ai që e kishte syrgjynosur e thirri sërish, në kohët kur i duhej më shumë. Këtë nuk na e tregon më historia e ndërtuar nga studiuesit tanë, por nga vetë sulltani i fundit, Abdyl-Hamidi II, sipas rrëfimit të të cilit skicohet një portret i ri

i Ismail Qemalit, disi ndryshe nga ai i formatizuar me konture të sakta nga historia jonë. Sulltani i fundit, ndërsa tregon jetën e tij, që nga ditët e para kur e sollën në pushtet e deri në ditët e fundit të perandorisë së tij, na zbulon me sinqeritetin e tij një fakt që nuk rrjedh aspak i forcuar, përkundrazi, vjen krejt i natyrshëm: ka qenë një moment kur ai dhe Ismail Qemali nuk janë parë si rivalë të njëri-tjetrit, por si dy aleatë të shqetësuar për të mbrojtur ligjin dhe për të shpëtuar Perandorinë. Një moment i tillë e shumë të tjerë si ai, që zbulojnë anë të panjohura të Ismail Qemalit, deri në ditën kur mbërriti në Shqipëri për të ngritur flamurin në Vlorë, zbulohen në librin "Sulltani i fundit" të Mishel de Gres, që është sjellë në shqip nga "Plejad". E sipas kësaj historie, plaku i Vlorës ka ditur të luajë me dinakëri, jo vetëm për Shqipërinë. Karriera e mbarë politike, aq sa arrin të bëhet dhe president i parlamentit turk, në kohën më të keqe të sulltanit të fundit, është një tregues i qartë i kësaj loje.

Rishfaqja e Ismail Qemalit pranë Portës së Lartë ndodhi në kohët kur sulltan Abdyl Hamidi II po ndjente fundin e perandorisë së tij dhe kur i duhej të bënte përçapjet e fundit për të mbijetuar. Ishte koha kur Anglia dhe Rusia, që kishin qenë në një garë të egër dhjetëvjeçare xhelozish, urrejtjesh, luftërash të hapura dhe konfliktesh të padukshme, u afruan me njëra-tjetrën. Një afrim ky, që habiti gjithë botën e që e pikëlloi shumë sulltanin, sepse ky bashkim i rivalëve të vjetër do të thoshte për të, fundi i politikës së përçarjes, të cilën e kishte përdorur me sukses gjatë shumë viteve të krizës. Në një moment të tillë sulltani tregon në libër se kishte arritur të pyeste pa-pushim veten: "A kishim arritur ne,

“...ka qenë një moment kur ai dhe Ismail Qemali nuk janë parë si rivalë të njëri-tjetrit, por si dy aleatë të shqetësuar për të mbrojtur ligjin dhe për të shpëtuar Perandorinë...”

kombi dhe unë në fundin fatal, të cilin e kisha parashikuar prej shumë kohësh e që isha përpjekur të shtyja deri tani?” E si të mos mjaftonte ai bashkim rivalësh, krizën e sulltanit do ta shtonte dhe komiteti “Bashkim e Përparim”, që në të njëjtën kohë kishte evoluar në lëvizjet e tij. Abdyl Hamidi II rrëfen në këtë libër, se “isha informuar dhe kisha rënë në gjurmët e një komiteti, që mund t’i kishte rrënjët në gjithë Maqedoninë e Shqipërinë, madje dhe në disa qytete të Turqisë aziatike, ndaj ngrita një komision special, kinse për ta inspektuar këtë grupim”. Por objektivi i komisionit ishte që t’i jepte fund veprimtarisë së komitetit të shoqërisë “Bashkim e Përparim”. Ndaj më 16 korrik shpalla një amnisti për të gjithë anëtarët e komitetit “Bashkim e Përparim”. Por kjo nuk do të zgjidhte asgjë. Ndaj sulltan Abdyl Hamidi II u dorëzua përpara kërkesës së vazhdueshme të këtij komiteti për rivendosjen e menjëhershme të kushtetutës së vitit 1876. “Më 17 dhjetor 1908 u zhvillua ceremonia e hapjes së parlamentit. Në orën 11 në Parlament filluan të vijnë deputetët dhe personalitetet e larta. Në orën një fiks,

deputetë e zyrtarë të tjerë, u çuan në këmbë, me një heshtje varri. Midis deputetëve të Shqipërisë dallova Ismail bej Qemalin, që ishte kthyer nga mërgimi. Kur sekretari lëshoi, gati si një sfidë, frazën e fjalimit tim “Në kundërshtim me të gjithë ata që kishin mendim tjetër, ne shpallëm vënien në fuqi të Kushtetutës dhe urdhëruam zgjedhje të reja”, deputetët e prishën heshtjen duke treguar një miratim solemn”.

Por nuk qe’ e thënë që të përfundonte me kaq. Parlamenti i sapoçelur u përça, sepse përkrahës të shumtë të rivendosjes së ligjit të shenjtë të Sheriatit u ngritën kundër laicitetit të Kushtetutës. Ata ishin të shumtë: oficerë, funksionarë, fshatarë, punëtorë, tregtarë...” Në agimin e 13 prillit të vitit 1909”, shkruan Abdyl Hamidi II “u zgjova nga të shtëna pushkësh. Qarkullonin fjalë shumë alarmante: regjimentet do të hidheshin njëri pas tjetrit në kryengritje”, kujton sulltan Abdyl Hamidi II. Në një moment të tillë, sipas rrëfimit të sulltanit duket qartë që Ismail Qemali ka dhënë kontributin e tij, që brenda parlamentit. Një kontribut që në pamje të parë nuk duket se ka të bëjë shumë me Shqipërinë. “Ismail bej Qemalit i ishte dashur të pushtonte centralin telefonik të Parlamentit, sepse ndërtesa ndodhej në duart e ushtrisë. Jashtë ndërtesës ndodheshin rreth njëzet e pesë mijë ushtarë, kurse holli dhe galeritë e dhomës së deputetëve ishin plot me njerëz të armatosur e ku nuk bëhej asnjë oficer i gjallë”.

Si dhe shumë gjëra tjera interesante dhe me rëndësi. Sugjeroj që kohën e lirë ta mbushni duke e lexuar këtë libër mbresëlënës. ■

AFGANISTANI

SHKRUAN: DRITON LEKAJ



Të dhëna të përgjithshme:

Emri i plotë: Republika Islamike e Afganistanit.

Kryeqyteti: Kabul

Sipërfaqja: 647,500 km².

Banorët¹ deri më 2007 : 31,889,923

Përqindja vjetore e rritjes së banorëve (2000 - 2005): 3.7 %

Përqindja e myslimanëve: 99 %.


Gjuha : Pashtunijje, Dari (Persishte) dhe disa dialekte të gjuhës turke.

Monedha : Rijali Afgan.

Pavarësia: 19 Gusht 1919 (nga Britanikët)

Anëtar i Kombeve të Bashkuara: 19 Nëntor 1946

Anëtar i Konferencës Islamike: 1969



Historia e tij: Atë e çliroi Ahnaf b. Kajsi në vitin 22 sipas hixhretit apo 642 sipas kalendarit diellor dhe kjo ka ndodhur në kohën e sundimit të Halifit të dytë Omer b.

Hatabit, Allahu qoftë i kënaqur me të. Shteti Gaznevid konsiderohet shteti më i rëndësishëm musliman që u ngrit mbi tokat e Afganistanit. Që nga viti 1933 vendi ishte

¹ Shifrat janë të përafërta për shkak të mungesës së statistikave të sakta.

monarki e pastaj që nga data: 17/7/1973 Afganistani u kthye në republikë. Në vitin 27/12/1979 fillon pushtimi sovjetik. Forcat sovjetike u tërhoqën më 15/2/1989², por më pas filloi lufta civile, e cila zgjati deri në vitin 1995, kur Talebanët shtrinë sundimin e tyre në 80% të sipërfaqes së vendit e më pas deri më 2000 e shtrinë sundimin e tyre në 95% të sipërfaqes së Afganistanit.


Pas ngjarjeve të 11 Shtatorit 2001 forcat amerikane e pushtuan Afganistanin dhe duke filluar nga 7/11/2001 bombarduan objektiva strategjike mbi kryeqytetin e vendit, Kabul. Bombardimi zgjati me ditë të tëra me argumentin e shkatërrimit të

Talebanëve.

Vlen të përmendet se Afganistani ishte ndër shtetet e para që njohën zyrtarisht pavarësinë e Republikës së Kosovës.

Afganistani prodhon: Grurë, hashash dhe vlen të përmendet se vendi vuan ende nga tregtia e drogës³. Krijta e gjedhëve përbën elementin themelor të ekonomisë. Gjithashtu Afganistani është i pari në botë për sa i përket nxjerrjes së gurit të çmuar me ngjyrë të kaltër - Lazard. Po ashtu në të ka: naftë, gaz natyror, qymyr, ar, argjend, hekur, plumb. Gjithashtu ka të zhvilluar edhe industrinë e tekstilit, sixhadeve dhe çimentos.⁴

ALGJERIA



² 1.5 milion afganë vdiqën në luftë kundër sovjetikëve, si dhe në luftën civile.

³ Mbjellja e opiumit edhe pas rrëzimit të regjimit të Talebanëve vazhdon ende dhe është produkti më i eksportuar i Afganistanit në botën perëndimore. (<http://sq.wikipedia.org/wiki/Afganistani>)

⁴ Të dhënat kryesisht bazohen në librin: Atlasi i shteteve Islame i Dr. Shevki Ebu Halil, si dhe në enciklopedinë botërore wikipedia.org

Të dhëna të përgjithshme:

Emri i plotë: Republika Demokratike Popullore e Algjerisë

Kryeqyteti: Algjer

Sipërfaqja: 2,381,741 km².

Banorët deri më vitin 2007 : 33,330,216

Përqindja vjetore e rritjes së banorëve (2000 - 2005): 1.8 %

Përqindja e muslimanëve: 99 %.

Gjuha : Arabishtja¹, Berberishtja dhe Frëngjishtja.

Monedha: Dinari Algjerian.

Pavarësia: 5 Korrik 1962 (nga Franca).

Anëtar në OKB: 8 Tetor 1962.

Anëtar në Konferencën Islamike: 1969.

Anëtar i Ligës së Shteteve Arabe:

16 Tetor 1962



Historia e tij: Algjeria është çliruar gjatë kalifatit të Osmanit, Allahu qoftë i kënaqur me të, në vitin 21 sipas hixhretit apo 464 sipas kalendarit diellor. Pastaj vazhduan çlirimet gjatë dinastisë emevite e më pas edhe gjatë Shtetit Abasit, e pastaj u ngrit Shteti i Beni Zirëve. Pas tyre erdhën Fatimitët, Murabitët, Muvehidunët gjersa triumfoi mbi ta Benu Zejjani në vitin 669 h. /1270 g. Këta të fundit u vendosën në qytetin Tlemsen dhe e shpallën atë kryeqytetin e tyre. Pas rënies së Andalusit (Spanjës) më 1492 g. luftërat detare dhe ato tokësore me spanjollët nuk u ndalën. Në vitin 918 h./1517 g. Hajredin Barbarosa e çliroi Algjerinë prej Spanjollëve e që më pas do të hynte nën sundimin osman në vitin 1517 dhe udhëheqësit e tyre njiheshin si Dajat. Kështu vazhdoi derisa e kolonizuan Francezët në vitin 1830.

Revolucioni kundër francezëve u zhvillua që nga viti 1954 e deri më 1962. Marrëveshjet në Evian më 18/3/1962 e çuan vendin drejt pavarësisë më 15/6/1962.²

Pas zgjedhjeve të lira të vitit 2001 dhe fitores së thellë të islamistëve nga partia FIS (Fronti Islamik i Shpëtimit) u krye një grusht-shteti ushtarak i udhëhequr nga gjeneralët e armatës algjeriane dhe si pasojë kjo shkaktoi luftën civile, e cila mori jetën e më se 120.000 njerëzve deri më tani. Algjeria është në rrugën drejt pajtimit mbarëkombëtar dhe konflikti është zbutur ndjeshëm.

Algjeria prodhon: Drithëra, rrush, ullinj, gjithashtu është e pasur me naftë dhe gaz natyror (ajo është prodhuesi i dytë botëror i gazit dhe kjo përbën 95 % të eksportit të saj). Po ashtu është e pasur me plumb, lëndë të parë hekuri dhe zink.

¹(Më 26/12/1990 Parlamenti vendosi që të bëhej Gjuha Arabe gjuhë zyrtare e përgjithshme dhe kohët e fundit edhe berberishtja është pranuar si gjuhë nacionale).

² Por kjo luftë e përgjakshme për lirinë e vendit pati një kosto të lartë ku mbi 500.000 civilë humbën jetën sipas <http://encarta.msn.com/encyclopedia/7615541288/Algeria.html> . E disa burime tjera flasin për më shumë se 1.000.000 viktima.


DISA PYETJE

ME PËRGJIGJE NGA: ALI SHABANI

Pyetja e parë: Esselamu alejkum. A është e lejuar që të agjërohet pas Ramazanit ditët e betimit (kefareti për betimin) dhe çdo ditë tjetër, që kompensimi i tyre është farz dhe a lejohet që ditët e betimit (3) të agjërohen veçan? Allahu ju shpërbleftë.

Përgjigje: Bismilahir rahmanir rahim. Të gjitha llojet e agjërit mund të kryhen pas agjërit të Ramazanit, që është detyrim dhe prioritar, por dua të jap një sqarim për agjërimin që është kefareti (shpagim) për betimin që nuk e realizon, pasi është përhapur në mesin e njerëzve, se po u betove dhe nuk e përmbush betimin, duhet agjëruar tre ditë. Megjithatë nuk është ashtu, sepse agjërimi si kefareti i betimit të parealizuar është nëse nuk ke mundësi të realizosh njërin nga tre kefaretet, që janë përmendur në ajetin e mëposhtëm. Allahu i Madhëruar thotë: ***“Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet e juaja të paqëllimta (për betim), por ju merr për ato që jeni zotuar qëllimisht. E shpagimi i tij (i betimit të bërë) është të ushqesh dhjetë të varfër me ushqim mesatar që ushqeni familjen tuaj, ose duke i veshur ata (të dhjetë), ose duke liruar një rob. E kush nuk ka mundësi t’i bëjë këto, le të agjërojë tri ditë. Ky është shpagim për betimet tuaja kur i thyni ato. Ruani betimet tuaja. Kështu Allahu ju sqaron dispozitat e veta, ashtu që të jeni mirënjohës”***. Maide 89.

Nëse me të vërtetë nuk ke mundësi të realizosh njërin nga tre kefaretet e para, atëherë kalohet te agjërimi i tre ditëve. Nëse



ky agjërim të ka mbetur pa u kryer dhe ke agjërim nga Ramazani, atëherë agjëron ditët që të kanë mbetur nga Ramazani e pastaj të kefaretit. Mirëpo duhet pasur kujdes që mos të të kapi Ramazani i ardhshëm pa u realizuar këto kompensime. Shumë dijetarë janë të mendimit se nëse e vonon pa arsye derisa të vijë muaji i Ramazanit, bie në mëkat për të cilin ke përgjegjësi në Ditën e Gjykimit. Allahu e di më mirë.

Pyetja e dytë: I nderuar hoxhë, prej cilës moshë duhet të agjërojmë dhe kush?

Përgjigje: Në emër të Allahut që s'ka hyjni të vërtetë, përpos Tij. Agjërimi është detyrim për çdo musliman që e ka mendjen të shëndoshë, me moshë pas pubertetit e më i madh, i shëndoshë e vendas. Për sa i përket gruas, ajo duhet të jetë e pastër nga menstruacionet dhe nga lehonja. Detyrim nuk e kanë: i çmenduri e fëmija (para pubertetit), sipas thënies së Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, që e përcjell Ibën Maxhe dhe Tirmidhiu në hadithin sahih: *“Është ngritur lapsi nga tre vetë: Nga i çmenduri derisa t'i rikthehet mendja, nga ai që është në gjumë derisa të zgjohet dhe nga fëmija derisa të arrijë pubertetin.”*

E sa i përket të sëmurit dhe udhëtarit, Allahu i Madhëruar ka thënë në Suren Bekare në ajetin 184: *“(Jeni të detyruar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai le të agjërojë më vonë aq ditë.”*, nga argumentet themi, se për moshën nuk është e caktuar saktësisht, se prej cilës moshë duhet filluar agjërimi, por ajo varet se kur hyn personi në pubertet, pasi kjo gjë është relative dhe dallon në mes mashkullit dhe femrës, në vendet e nxehta dhe të ftohta. Për të sëmurin vendos vetë individi, sipas mundësisë së tij, se a mundet të agjërojë apo jo! Nëse i sëmuri nuk shpreson

se në të ardhmen nuk do të shërohet për shkak edhe të moshës, atëherë pas Ramazanit nuk agjëron, por paguan **fidjen**. Allahu i Madhëruar ka thënë në Suren Bekare në ajetin 184: *“...E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të detyruar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është më e mirë për te. Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju”*.

Pra, duhet që për çdo ditë që nuk e agjëron nga ditët e muajit të Ramazanit të ushqesh nga një të varfër, gjegjësisht nga një racion.

Pyetja e tretë: Nëna ime po mundohet të mësojë të falet, por nuk po i mban mend duatë (lutjet), a mundet të falet duke shikuar në letër, ku janë të shkruara duatë deri sa të mësohet?

Përgjigje: Falënderimi i qoftë Allahut, lejohet të veprohet ashtu, pra, të shikohet në letër apo edhe me metoda të tjera në këtë kontekst, deri sa të mësojë mirë e të jetë e pavarur prej atyre fletëve dhe inshaAllah ka shpërblim për mundin që bën. Pejgamberi paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të ka thënë: *“Kush merr një rrugë me të cilën kërkon dituri, Allahu do t'ia lehtësojë rrugën për në Xhenet”*.

Pyetja e katërt: Jam pak e moshuar, i fali të pesë vaktet e namazit dhe i kryej edhe detyrimet e tjera të Fesë Islame, por nuk jam e mbuluar. A duhet patjetër të mbulohem? Mbulesa a është detyrim patjetër apo jo? Ju faleminderit.

Përgjigje: Falënderimi qoftë për Allahun dhe salavatet për të Dërguarin e Allahut, mbulesa është detyrim i prerë farz për gratë e umetit të Muhamedit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. Ato janë të detyruara të mbulojnë tërë trupin në përgjithësi dhe kur falin namaz në veçanti. Në periudhën

pejgamberike gratë e atëhershme e kanë mbuluar trupin dhe kokat, por nuk ka qenë mbulesë e kompletuar dhe është dashur të plotësohet, siç e shohim në ajetin, ku flitet për detyrimin e mbulesës (hixhabit). Allahu i Madhëruar ka thënë në suren Nur në ajetin 31: *“Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme, le të venë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, babait të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmendën) dhe robërshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt, të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat, ose fëmijët që nuk e kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për ta zbuluar fshehtësinë e stolive të tyre. Pendohuni të gjithë tek Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim”.*

Edhe reagimi i Pejgamberit përputhet me ajetin, siç e vërejmë në hadithin, që përcjell Ebu Davudi nga Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me te, kur Esmaja, bija e Ebu Bekrit ka shkuar te Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, e ajo kishte rroba të tejdukshme. Pejgamberi kthehet në anën tjetër dhe i thotë: Oj Esmaja, gruaja kur të arrijë pjekurinë, nuk i lejohet t’i shihen (nga trupi saj), përpos këto.- dhe ka bërë me shenjë nga fytyra dhe duart.

Pyetja e pestë: Selamu alejkum! Unë jam një vajzë e re dhe besimtare dhe ka kohë që

po kaloj me një djalë dhe meqë nuk dua të bëj haram, a bën të vendoset kurora, nëse prindërit s’pajtohen?... Allahu ju shpërbleftë për përgjigjen.

Pyetja e gjashtë: Es-selamu alejkum. Jam një vajzë e re dhe besimtare, por një gjë më mundon shumë kohët e fundit. Jam e dashuruar, por familja ende nuk e di, ngase kam frikë nga reagimi i tyre, dhe për këtë ju pyes se: a mundet që nëse prindërit nuk pajtohen, unë të vendos kurorë pa lejen e tyre. Allahu ju shpërbleftë.

Përgjigje e pyetjes së pestë dhe të gjashtë:

Në emër të Allahut Mëshiruesit Mëshirëplotit. Allahu i Madhëruar i ka krijuar njerëzit meshkuj dhe femra, dhe ka zbritur rregulla e dispozita për bashkimin e tyre. Allahu i Madhëruar thotë: *“Dhe nga faktet (e madhështisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë”.* Rum 21

Ndërsa i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Ajo grua që e marton veten e vet pa lejen e veliut (përgjegjësit) të saj, atë martesë e ka batil (të pavlefshme).”* Velij i gruas në radhë të parë është babai i saj, nëse nuk ka baba, atëherë vëllai më i madh (me moshë madhore). Nëse nuk ka vëlla njëri nga gjyshërit, nëse nuk i ka këta, atëherë mixha, ose daja, nëse nuk i ka këta atëherë veliu i saj bëhet hoxha me autoritet në vend. Përndryshe asnjë vajze nuk i lejohet të martohet pa lejen e prindërit, gjegjësisht të babait. ■

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t’i dërgoni në albislam@gmail.com



HIDRI DHE GJURMËT E TIJ MES REALITETIT DHE BESËTYTNIVE

Është më se e nevojshme të përhapim të kuptuarit e gjeneratave të para (selefit) në të gjitha çështjet fetare e në veçanti gjërat që kanë ndodhur në të kaluarën, si duhet t'i kuptojmë ato dhe si duhet t'i dimë ne.

PËRGATITI: BEDRI LIKA

Falënderimi i takon Allahut subhanehu ue teala, lavdërimet dhe përshëndetjet ia dërgojmë të dërguarit tonë Muhamedit alejhi selam, familjes së tij të nderuar

shokëve të tij besnikë dhe atyre që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Është më se e nevojshme të përhapim të kuptuarit e gjeneratave të para (selefit) në të gjitha çështjet fetare e në veçanti gjërat që kanë ndodhur në të kaluarën, si duhet t'i kuptojmë ato dhe si duhet t'i dimë ne.

Kur Musai alejhi salam u kthye në Egjipt, u mbajti një ligjëratë Beni Israilëve derisa u lotuan sytë dhe iu zbutën zemrat atyre. Njëri prej tyre e pyeti Musain alejhi salam: O i Dërguari i Allahut, a ekziston dikush në sipërfaqen e tokës që është më i ditur se ti? Ai tha: Jo, - duke u nisur nga ajo që ishte në dijen e tij dhe si stimulim për ta pranuar atë që po thotë ai.

Allahu subhanehu ue tealë e qortoi Musain alejhi salam për ato që tha dhe e informoi se ekziston një njeri, i cili zotëron atë dije, të cilën Musai alejhi salam nuk e zotëron. Gjithashtu Allahu subhanehu ue tealë e njoftoi se ai zotëron inspirime të jashtëzakonshme, derisa Musai alejhi salam u përmallua që të takohet me te dhe të shikojë se çfarë zotëron ai nga dija dhe i kërkoi Allahut që të takohet me te.

Allahu subhanehu ue tealë, e lajmëroi Musain alejhi salam për vendin ku gjendet ai, ashtu siç na tregohet në Kuranin Famëlartë:

“Dhe, kur arritën në vendin, ku bashkoheshin dy detet, ata e harruan peshkun e tyre dhe ai rrëshqiti në det, duke e hapur atë si tunel. Kur kaluan më tej, Musai i tha shoqëruesit të vet: “Na jep drekën tonë, sepse jemi të lodhur nga udhëtimi ynë”. Ai u përgjigj: “Shiko! Kur ndaluam tek ai shkëmbi, unë e harrova peshkun. Vetëm djalli më bëri ta harroj e nuk ta thashë se peshku mori rrugën nëpër det në mënyrë të habitshme! (Musai) tha: “Kjo është ajo që po kërkojmë”. Prandaj u kthyen nëpër gjurmët e veta, dhe gjetën një prej robërve Tanë, të cilit i patëm dhuruar mëshirë prej Nesh dhe i kishim mësuar nga ana Jonë dije. Musai i tha atij: “A mund të të ndjek ty, që të më mësosh edhe mua diçka prej dëtarisë së drejtë që të është dhënë ty?”. Ai u përgjigj: “Ti nuk mund të durosh dot me mua! E si mund të durosh pa pyetur para diçkaje për të cilën nuk di asgjë?

(Musai) tha: “Do të më gjesh të durueshëm, në dashtë Allahu e nuk do të të kundërshtoj për asgjë”. (Hidri) i tha: “Nëse vjen pas meje, mos më pyet për asgjë, derisa të ta shpjegoj unë!”. Dhe kështu u nisën. Kur hipën në një anije, ai (Hidri) hapi një vrimë poshtë. (Musai) tha: Mos vallë, e hape vrimën për t’i mbytur udhëtarët e saj? Me të vërtetë, ke bërë punë shumë të keqe”. (Hidri) i tha: “A nuk të thashë se ti nuk mund të durosh me mua?”. Ai u përgjigj: “Mos më qorto për atë që harrova dhe mos më ngarko me vështirësi në punët e mia!”. Dhe që të dy vazhduan të ecin, derisa takuan një djalosh, të cilin ai (Hidri) e vrau. Tha (Musai): “Përse vrave një njeri të pafajshëm që nuk ka vrarë askënd?! Vërtet që ke bërë një punë të tmerrshme!” Ai u përgjigj: A nuk të thashë se ti nuk mund të durosh me mua?” (Musai) tha: “Nëse pas kësaj do të të pyes sërish për çfarëdo gjëje, atëherë mos më mbaj më në shoqërinë tënde! Tashmë ke arsye të mjaftueshme nga ana ime (për t’u ndarë prej meje)!” Dhe që të dy vazhduan të ecin, derisa arritën në një fshat dhe u kërkuan banorëve të tij, që t’u jepnin për të ngrënë, por ata nuk i pranuan mysafirë. Aty ndeshën një mur që ishte duke u rrëzuar dhe ai (Hidri) e drejtoi. (Musai) tha: “Sikur të kishe dashur ti mund të kërkoje shpërblim për këtë”. Ai tha: “Kjo është ndarja ndërmjet meje dhe teje. Unë do t’i shpjegoj ty ato gjëra për të cilat nuk munde të durosh. Sa i përket anijes, ajo ishte pronë e disa të varfërve, që punonin në det. Unë desha ta dëmtoj, sepse prapa tyre gjendej një mbret, i cili merrte me dhunë çdo anije të mirë. Sa për djaloshin, prindërit e tij ishin besimtarë. Ne e dinim se dashuria për të do t’i çonte ata në rrugë të keqe dhe mohim, dhe dëshiroam që Zoti i tyre, në vend të atij t’u jepte një më të mirë, më të pastër dhe më të mëshirshëm. E, sa i përket murit, ai u takonte dy djelmohave jetimë në qytet dhe nën të

gjendej një thesar i tyre. Babai i tyre kishte qenë njeri i mirë, prandaj Zoti yt dëshiroi që ata të arrinin moshën e pjekurisë e ta nxirrnin thesarin e tyre vetë, si mëshirë nga Zoti yt. Unë këtë nuk e kam bërë sipas gjykimit tim. Ky është shpjegimi i asaj, për të cilën ti s'munde të duroje!” (Kehf 61-82)

Nga e gjithë kjo histori që na tregon Kurani Famëllartë mbi ndodhinë e Hidrit dhe të Musait alejhima selam mund të vijmë në përfundimin, se Allahu kishte si qëllim që ta vetëdijesojë Musain alejhi selam, se më i dituri është Allahu subhanehu ve teala, e pastaj i tregoi për njeriun, i cili zotëron një dije, të cilën nuk e kishte Musai alejhi selam.

A ËSHTË HIDRI PEJGAMBER ?

Dijetarët muslimanë nuk janë të një mendimi për këtë çështje, disa prej tyre thonë se ai është pejgamber e disa të tjerë thonë se ai është evlija.

Argumentet e atyre që thonë se Hidri nuk është pejgamber:

Allahu subhanehu ue teala na tregon, se ai ka qenë një njeri i mirë, i dijshtëm, i inspiruar, mirëpo krahas gjithë këtyre cilësive të mira Allahu nuk na tregon se ka qenë pejgamber.

Ebu el-Kasim el-Kushejri thotë: Hidri nuk ka qenë pejgamber, por ka qenë velij.

Argumentet e atyre që thonë, se Hidri ka qenë pejgamber:

Ibën Kethiri thotë: Nga konteksti i ajeteve kuranore në disa aspekte nënkuptojmë, se Hidri ka qenë pejgamber:

E para: Ajeti kuranor: Dhe e gjetën një prej robërve Tanë, të cilit i kemi dhuruar mëshirë nga ana Jonë dhe e kemi mësuar me një dituri të posaçme nga Ne.

E dyta: Kur Musai alejhi selam i tha Hidrit: A pranon të vij me ty që të më

mësosh nga ajo që je i mësuar ti, dituri të drejtë e të vërtetë?

Ai Hidri tha: Sigurisht ti nuk do të mund të kesh durim me mua! Si do të durosh për atë që nuk je i njoftuar?

Musai tha: Nëse do Allahu, do të jem i durueshëm dhe nuk do të kundërshtoj ty për asgjë.

Hidri tha: Nëse më shoqëron, mos më pyet për asgjë deri sa të tregoj unë për të.

Sikur të mos ishte Hidri pejgamber, nuk do t'i drejtohej Musait alejhi selam në këtë mënyrë, po ashtu Musai alejhi selam nuk e kundërshtoi Hidrin për këtë, por kërkoi nga ai që të shoqërohej me të dhe të përfitojë nga dija e tij.

E treta: Hidri e mbyti atë djalosh e kjo mund të ndodhë vetëm me shpallje nga Allahu subhanehu ue teala dhe kjo është një argument i veçantë, që tregon se Hidri ka qenë pejgamber. Sikur të kishte qenë evlija, nuk do të ishte e lejuar për te, që ta mbysë djaloshin.

Sa i përket jetës dhe vdekjes së Hidrit ekziston një mospajtim tek dijetarët, mirëpo argumentet tregojnë se ai ka vdekur, të këtij mendimi janë shumica e muhadithëve, për arsye se nuk ekziston ndonjë argument i qartë që ai jeton. Sikur të kishte qenë gjallë Hidri alejhi selam do të kishte qenë e detyruar që të takohet me Muhamedin alejhi selam dhe ta ndjekë atë, ashtu sikurse Isai alejhi selam, kur do të zbresë para Ditës së Kiametit do të gjykojë me sheriatin e Muhamedit alejhi selam.

Po ashtu nuk është vërtetuar me asnjë hadith sahih apo hasen, se Hidri është takuar me Muhamedin alejhi selam, e as që ka marrë pjesë në ndonjë prej betejave, që janë zhvilluar në kohën e Muhamedit alejhi selam. ■